

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 5985  
E shtunë, 25 janar 2020  
çmimi 0.40 €

## Përse nuk po krijohet Qeveria e Kosovës

IFAQE 7

Bedri Islami



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", SABRI KIÇMARI IFAQE 4-5

# IMPONIMI I DORËHEQJES SË KRYETARIT TË KUVENDIT NUK MË DUKET ZGJIDHJE E MENÇUR



Ish-kandidati për deputet i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Sabri Kiçmari, beson se në Lëvizjen Vetëvendosje dhe Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) do të dëgjohet zëri i mendjeve racionale dhe do të formohet koalicioni qeverisës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se këto dy parti duhet të

heqin dorë nga interesi partiak dhe ta shohin interesin kombëtar. Sipas Kiçmarit, këto dy subjekte politike kanë shansin të krijojnë një realitet të ri demokratik dhe t'i vendosin bazat e një kulture të re demokratike në Kosovë. Ai ka thënë se imponimi i dorëheqjes së kryetarit të Kuvendit nuk i duket zgjidhje

## - LV-LDK kanë shansin të krijojnë një realitet të ri demokratik

e mençur. Kiçmari ka folur edhe për mundësinë e shkuarjes në zgjedhje të reja. Ai ka theksuar se është nevojë urgjente që, edhe në rast se shkohet në zgjedhje, paraprakisht të gjendet një zgjidhje legale, qoftë edhe e përkohshme, për të mos e sjellë në gjendje kolapsi funksionalitetin buxhetor

## Rama dhe Haradinaj vazhdojnë akuzat për idenë e ndarjes

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dhe kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, sërish kanë drejtuar akuzat ndaj njëri-tjetrit për idenë e ndarjes së Kosovës. Haradinaj ka thënë

se Rama e ka përkrahur idenë e ndarjes së Kosovës, ndërsa Rama ka reaguar, duke thënë se Haradinaj e ka kthyer shpifjen në pushkë qëkur e ka lënë pushkën

IFAQE 3



## OPINION

### MAGNETIZIMI I MATERIALEVE FEROMAGNETIKE

F. 11

Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan



## AKTUALE



### GRENELLI FTON PRISHTINËN DHE BEOGRADIN TA FINALIZOJNË MARRËVESHJEN PËR HEKURUDHAT

F. 2

### IKSHPK-ja NDËRMERR MASA PËR VIRUSIN E RI '2019-NCOV'

F. 8

### SI TË IKET NGA 'KULTURA E KORRUPSIONIT'?

F. 6

## EKONOMI

### DREJTORIT TË DOGANËS I VAZHDOHET MANDATI EDHE PËR TRI VJET

F. 9

### IMPLEMENTIMI I PARIMEVE TË QEVERISJES KORPORATIVE DO T'I FUQIZONTE NDËRMARRJET PRIVATE

F. 9

## KULTURË

### ETEMAJ BOTON MONOGRAFINË PËR LËVIZJEN E PAJTIMIT TË GJAQEVË

F. 9

### POSHTË URËS ATY MBI LUMËBARDH

F. 9 / Ylli Mece

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curez-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Grenelli fton Prishtinën dhe Beogradin ta finalizojnë marrëveshjen për hekurudhat

I dërguari i posaçëm i ShBA-së për dialogun Beograd - Prishtinë, Richard Grenell, ka njoftuar të premten në Beograd, pas takimit me presidentin serb Aleksandar Vuçiq, se do të ketë një marrëveshje edhe për transportin hekurudhor Kosovë - Serbi, por që për hollësitë do të negociohet nga grupet punuese të hënën në Berlin



**PRISHTINË, 24 JANAR** - Grupet punuese nga Kosova dhe Serbia do të udhëtojnë më 27 janar në Berlin të Gjermanisë, për të diskutuar me të dërguarin e posaçëm të ShBA-së për dialogun Beograd - Prishtinë, Richard Grenell, rreth vendosjes së linjës hekurudhore midis dy vendeve. Kështu u bë me dije pas takimit të zhvilluar në Beograd ndërmjet presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq dhe ambasadorit amerikan, Richard Grenell.

Në një konferencë për media presidenti serb Vuçiq tha se marrëveshja do të jetë e ngjashme me atë të linjës ajrore Prishtinë - Beograd, e cila u arrit në fillim të kësaj jave me ndërmjetësimin e diplomatëve amerikanë. "Bisedova për lidhjen e mëtejshme infrastrukturorë midis Prishtinës dhe Beogradit. Kemi biseduar edhe për vendosjen e linjës hekurudhore në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Lidhur me këtë, deklarova që është e rëndësishme që taksat të hiqet sepse do të ishte e pakuptimtë të kemi qarkullim hekurudhor pa mallra", tha Vuçiq.

Edhe ambasadori Grenell konfirmoi se tashmë ekziston një marrëveshje në parim lidhur me këtë çështje. "Ne kemi një mar-

rëveshje në parim dhe do të takohemi në Berlin të hënën. Unë gjithashtu e diskutova këtë çështje me presidentin (e Kosovës, Hashim) Thaçi dhe me liderët që po përpiqen ta formojnë Qeverinë e Kosovës si dhe me presidentin Vuçiq. Tani le të ulemi dhe të dalim me një marrëveshje për hekurudhat", tha Grenell.

Ambasadori Grenell e ka vizituar Beogradin pas qëndrimit në Prishtinë, ku ka kërkuar nga autoritetet e Kosovës ta heqin taksën ndaj mallrave serbe, ndërkaq nga Beogradi të mos vazhdojë më fushatën kundër njohjeve të Kosovës.

Të njëjtën kërkesë ai e përsëriti edhe në Beograd, derisa ftoi të dyja palët të fokusohen në zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës. "Unë jam këtu për t'i shtyrë të dyja palët për bashkëpunim ekonomik. Jua lë politikën juve", tha Grenell.

Bisedimet për mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë ndërprerë në fund të vitit 2018, pasi Qeveria e Kosovës vendosi taksë ndaj mallrave nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina.

Ambasadori Grenell tha më 23 janar në Beograd se Kosova dhe

Serbia duhet ta shfrytëzojnë mundësinë e arritjes së marrëveshjes. "Po ndiej një energji të mirë nga të dyja anët (Kosovë e Serbi), por presidenti (i ShBA-së), Donald Trump, nuk do të më lejojë të punojë gjatë në këtë çështje nëse nuk ka ndonjë përparim", tha ambasadori Richard Grenell. Më 20 janar në Ambasadën Amerikane në Berlin, me anë të një ceremonie, në praninë e ambasadorit amerikan Richard Grenell, përfaqësuesit e kompanisë "Lufthansa" i kanë dorëzuar Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës letrën me të cilën i njoftojnë autoritetet e Kosovës për operimin e aviokompanisë "Lufthansa" në linjën Prishtinë - Beograd. Lidhur me këtë insti-

tucionet e Kosovës do ta ofrojnë përkrahjen e nevojshme si për fluturimet e tjera.

Të gjitha fluturimet kërkojnë aprovimet dhe licencat sipas kërkesave rregullatore të zbatueshme në Republikën e Kosovës si dhe bazuar në legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjen për Hapësirën e Përbashkët Ajrore Evropiane (HPAE (ECAA).

Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, Eset Berisha, është shprehur se kjo letër është një hap tjetër përpara për angazhimin e institucioneve të Kosovës për normalizim të plotë të hapësirës ajrore në Kosovë.

Presidenti Hashim Thaçi ka mirëpritur nënshkrimin e letrës së qëllimit ndërmjet kompanisë

ajrore prestigjioze gjermane "Lufthansa" dhe Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, e cila mundëson hapjen e linjës ajrore Prishtinë - Beograd. "Sigurisht se kjo ngjarje shënon një hap tjetër në përpjekjet tona për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Prandaj, në emër të institucioneve shtetërore dhe qytetarëve tanë shpreh mirënjohjen e thellë për ambasadorin e ShBA-së në Berlin, Richard Grenell, si dhe këshilltarin për siguri kombëtare të presidentit Trump, Robert O'Brien, për kontributin e tyre për këtë marrëveshje, e cila pritet ta lehtësojë lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave në të ardhmen", ka thënë presidenti Thaçi.

## Rama takohet me Merkelin të hënën në Berlin

**TIRANË, 24 JANAR** - Kancelarja gjermane Angela Merkel do të takohet të hënën në Berlin me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, bëri të ditur të premten zëvendës zëdhënësjë e Qeverisë gjermane, Ulrike Demmer. Në fokus të bisedës do të jetë ndihma që mund të japë Gjermania për rimëkëmbjen e dëmeve të tërmetit të 26 nëntorit 2019.

Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama e kishte paralajmëruar takimin me kancelaren gjer-

mane edhe në kuadër të vizitës së tij në Romë, ku ai mori premtimin për mbështetjen e Italisë në konferencën e donatorëve, që do të zhvillohet më 17 shkurt 2020 në Bruksel, nën udhëheqjen e kryetares së komisionit të BE-së, Ursula von der Leyen. Rama tha gjatë një bisede joforale me ministrin e Jashtëm të Italisë, Luigi di Maio, se kostoja e rimëkëmbjes së zonave të shkatërruara nga tërmeti përllogaritet deri tani të jetë afro një miliardë euro.

Temë tjetër e bisedimit, sipas Demmer, do të jetë kryesia e radhës së Shqipërisë në OSBE, marrëdhëniet bilaterale, situata në rajon dhe perspektiva evropiane e BE-së. Angela Merkel dhe Gjermania janë të angazhuar për çeljen sa më të shpejtë të negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Pas një bisede që pati javën e kaluar me kryeministrin kroat Plenković, Merkel e refuzoi trajtimin veç e veç të dy vendeve të



Ballkanit Perëndimor. "Nëse duam të jemi të drejtë, atëherë ne duhet t'i trajtojmë të dy vendet së bashku, pavarësisht

se ato pastaj do të ndjekin procedura të ndryshme, në bazë të vlerësimeve që do t'u bëhen", tha Merkel.

# Rama dhe Haradinaj vazhdojnë akuzat për idenë e ndarjes

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dhe kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, sërish kanë drejtuar akuza ndaj njëri-tjetrit për idenë e ndarjes së Kosovës. Haradinaj ka thënë se Rama e ka përkrahur idenë e ndarjes së Kosovës, ndërsa Rama ka reaguar duke thënë se Haradinaj e ka kthyer shpifjen në pushkë qëkur e ka lënë pushkën



**PRISHTINË, 24 JANAR (ER)** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dhe kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, kanë vazhduar polemikat për idenë e shkëmbimit të territoreve Kosovë - Serbi. Ky i fundit, në emisionin "Open" të "Top Channel", sërish e ka akuzuar kryeministrin shqiptar se e ka përkrahur idenë e ndarjes së Kosovës. Ndërsa kryeministri Edi Rama ka reaguar, duke thënë se Haradinaj e ka kthyer shpifjen në pushkë qëkur e ka lënë pushkën. "Ramushi e ka kthyer shpifjen në pushkë qëkur ka lënë pushkën! Por nëse për pushkën ia kam bërë të gjitha nderimet e mundshme dhe të merituar, për shpifjet nuk mund t'i bëj asgjë tjetër përveçse ta ftoj në gjykatën e Kosovës që t'u dalë për zot atyre që ka nxjerrë nga goja! Sepse ndryshe nga Ramushi dhe nga ai soj politikanësh që s'kanë fijen e respektit as për fjalën, as për të vërtetën, as për publikun, unë nuk ulem dot në nivelin e shpifësit publik për ta luftuar bërllokun me bërllok! Pafytyrësi nuk është të shkosh në gjykatë për t'u mbrojtur nga një shpifës që të ka cenuar publikisht dinjitetin, po t'i përdorësh kanalet e komunikimit publik për të shpifur në mënyrë të përsëritur!", ka vlerësuar Rama në një deklaratë për "Top Channel".

Ai ka mbrojtur padinë e tij për shpifje që i ka bërë kryeministrit të Kosovës. "Nuk është akt i turpshëm t'i nënshtrosh gjykimin të drejtësisë si viktimë e një shpifësi që të sulmon si tradhtar të kombit me fabrikime të ulëta, po turp është ta bësh agresorin ndaj dikujt tjetër për ta manipuluar opinionin publik duke fabrikuar gjëra krejt të paqena! E vërteta është se unë kam dashur ta ndaj Kosovën, po aq sa ç'ka dashur Ramushi ta ndajë Princ Harryn nga Familja Mbretërore! Shkurt fjala, komandanti i djeshëm i UÇK-së, Ramush Haradinaj, e ka merituar dhe do ta ketë për gjithë jetën respektin tim, për gjithçka i ka dhënë kauzës së lirisë së Kosovës, ndërsa politikani i sotëm, Ramush Haradinaj, meriton vetëm keqardhjen time për bërllokun politik e gjuhësor ku ushtron veprimtarinë dhe pushtetin e tij", ka thënë Rama, duke shtuar se është dëshpëruese kur sheh se si politika qorre e Haradinajt e ka dëmtuar keq Kosovën në sytë e miqve të saj të mëdhenj dhe i ka dhënë Serbisë një avantazh.

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, një ditë më parë ka drejtuar akuza të rënda ndaj kryeministrit Edi Rama, presidenti të Kosovës, Hashim Thaçi dhe publicistit Baton Haxhiu, se

kanë proklamuar idenë për shkëmbim të territoreve Kosovë - Serbi. "Me fanatizëm ka përkrahur idenë e shkëmbimit të territoreve, nganjëherë të quajtur korrigjim i kufijve për ndarje të Kosovës, mirëpo kam bërë kujdes të mjaftueshëm, edhe pse ka qenë një temë e rrezikshme dhe me pasoja, që të mos shkaktojë pasoja të tjera në marrëdhëniet tona ndërnjerëzore ndër shqiptare", ka deklaruar Haradinaj.

Ai ka vlerësuar se kushdo që ka

qëndruar prapa kësaj teme dhe që vazhdon me aktivitete për ta hedhur në jetë do ta marrë reagimin e njëjtë nga ai. "Sido që të jetë, nëse dikush që ka qëndruar pas kësaj teme, vazhdon me aktivitete që ndërlidhen me të, jam i detyruar t'ju përgjigjem, sikurse që kam qenë i detyruar ta kundërshtoj. Ju siguroj edhe një që mua më kanë dërguar njerëz të afërt të gjithë këta, po edhe vetë, mos i dil kundër se është punë e kryer, se kanë vendosur se është kësh-

tu, se është atje, ti mos u bë budalla, qysh ti po i del kësaj kundër kur të gjithë jemi për. Pra, kanë provuar për të lobuar, kanë provuar edhe në mënyra të tjera", ka thënë Haradinaj, duke përmendur edhe joshje të tjera. "Cila ka qenë joshja, do të mbetesh në pushtet, do të mbetesh i përjetshëm, do të bëhesh hero, do të bëhesh i njohur, do të hysh në histori, se ti do të bëhesh ai, kjo, ajo. Do të mbetesh mik i përjetshëm i këtij e i atij", është shprehur Haradinaj.

## Nënshkruhet memorandumi për ndarjen e granteve për fermerët e Skenderajt

**SKENDERAJ, 24 JANAR (ER)** - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur të premten në takim përfaqësuesen e Caritasit zviceran për Kosovë, Vera Haag Arbenz, me të cilën ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për mbështetjen dhe promovimin e prodhimit të bujqësorisë në Skenderaj. Me këtë rast, kryetari Jashari u shpreh falënderues ndaj Caritasit zviceran për përkrahjen që po i japin zhvillimit të bujqësisë në Komunën e Skenderajt, duke vlerësuar se investimi në bujqësi është baza e zhvillimit ekonomik të komunës sonë. Kryetari Jashari ka thënë se si komunë kanë investuar si asnjëherë më parë në bujqësi

dhe për çdo vit kanë rritur buxhetin për grante, duke shtuar se vetëm gjatë vitit 2019 kanë investuar mbi 150 mijë euro në bujqësi. "Me këtë memorandum të bashkëpunimit do të përkrahem rreth 25 fermerë, ku shuma totale e granteve do të arrijë në 57 000 euro", ka deklaruar Jashari. Ndërsa përfaqësuesja e Caritasit zviceran, Vera Haag Arbenz, ka deklaruar se e mirëpresin nënshkrimin e memorandumit me të cilin së bashku me Komunën e Skenderajt do të përkrahin fermerët që kultivojnë frutat malore, bimët mjekësore dhe prodhimin e mjaltit. Rreth procedurave të aplikimit dhe kriterëve të përzgjedhjes fermerët do të informohen me kohë.





Flet për "Epokën e re", Sabri Kicmari

# Imponimi i dorëheqjes së kryetarit të Kuvendit nuk më duket zgjidhje e mençur

- LV-LDK kanë shansin të krijojnë një realitet të ri demokratik

Ish-kandidati për deputet i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Sabri Kicmari, beson se në Lëvizjen Vetëvendosje dhe Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) do të dëgjohej zëri i mendjeve racionale dhe do të formohet koalicioni qeverisës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se këto dy parti duhet të heqin dorë nga interesi partiak dhe ta shohin interesin kombëtar. Sipas Kicmarit, këto dy subjekte politike kanë shansin të krijojnë një realitet të ri demokratik dhe t'i vendosin bazat e një kulture të re demokratike në Kosovë. Ai ka thënë se imponimi i dorëheqjes së kryetarit të Kuvendit nuk i duket zgjidhje e mençur. Kicmari ka folur edhe për mundësinë e shkuarjes në zgjedhje të reja. Ai ka theksuar se është nevojë urgjente që, edhe në rast se shkohet në zgjedhje, paraprakisht të gjendet një zgjidhje legale, qoftë edhe e përkohshme, për të mos e sjellë në gjendje kolapsi funksionalitetin buxhetor

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 JANAR - Ish-kandidati për deputet i Lëvizjes Vetëvendosje, Sabri Kicmari, ka ftuar LV-në dhe LDK-në që ta bëjnë sa më parë koalicionin qeverisës. Ai ka thënë se këto dy subjekte politike kanë shansin të krijojnë një realitet të ri demokratik dhe t'i vendosin bazat e një kulture të re demokratike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kicmari ka deklaruar se formimi i një koalicioni të tillë është interes kombëtar për Kosovën. "LV-ja dhe LDK-ja e kanë shansin të krijojnë një realitet të ri demokratik dhe t'i vendosin bazat e një kulture të re demokratike. I inkurajoj që ta

bëjnë këtë gjë! Interesi partiak duhet t'i lëshoj vendin interesit kombëtar, shtetëror dhe shoqëror. Besoj ende, se në të dy subjektet ka mendje racionale që e kanë këtë gjë parasysh dhe në ditët e ardhshme do të dëgjohej zëri i tyre", ka thënë Kicmari.

Ai ka vlerësuar se ideja e LDK-së për ta larguar kryetarin e ri të Kuvendit nuk është e qëlluar. "Në rrafshin e stabilitetit institucional, funksionimit demokratik të institucionit më të lartë ligjvënës dhe imazhit të Republikës së Kosovës, imponimi i dorëheqjes së kryetarit të Kuvendit nuk më duket zgjidhje e mençur. Kryetari i Kuvendit, sipas sistemit tonë kushtetues, është njeriu i dytë në hierarkinë shtetërore. Ai duhet të ketë

imunitet të plotë institucional dhe funksional dhe nuk mund të bëhet, pas zgjedhjes së tij, objekt i lëvizjes për shkak të interesave partiake", është shprehur ai.

Zyrtari i LV-së ka folur edhe për mundësinë e shkuarjes në zgjedhje të reja. Sipas tij, të dy subjektet politike duhet të mendojnë për ndonjë zgjidhje të përkohshme para zgjedhjeve të reja. "Natyrisht që nuk bëhet hataja nëse shkohet në zgjedhje të reja. Ka shumë raste të vendeve me stabilitet të qëndrueshëm demokratik kur ndodhen para situatave të tilla. Por, është nevojë urgjente që, edhe në rast se shkohet në zgjedhje, paraprakisht të gjendet një zgjidhje legale, qoftë edhe e përkohshme, për të mos



e sjellë në gjendje kolapsi funksionalitetin buxhetor", është shprehur Kiçmari.

**"Epoka e re":** Z. Kiçmari, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës ende nuk kanë arritur një marrëveshje edhe tre muaj pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 6 tetorit. Pse?

**Kiçmari:** Unë kam pritur më shumë probleme në akordimin e pikave programore për shkak se dy subjektet politike vijjnë nga drejtime të ndryshme ideologjike dhe kanë plane të ndryshme zhvillimore, por ja që ndodhi, që pengesë serioze e krijimit të koalicionit qeverisës të jetë ndarja e resorëve qeverisës dhe tejqeverisës. Pengesa e parë u shfaq me kërkesën e LDK-së, që pjesë e marrëveshjes së koalicionit të jetë edhe detyra e Presidentit të Republikës. Problem në vete ishte edhe insistimi i LDK-së për ta marrë resorin e Punëve të Brendshme, për të cilin resor LV-ja kishte proklamuar me të madhe angazhimet e saj në fushatë. LV-ja u thirr në principin e gjetjes së një kuadri neutral, jopartiak, për president, i cili do të pranohej nga të dy subjektet, në kohën e dhënë, kurse LDK-ja insistoi që mandati i Presidentit t'i takonte asaj, pa e bërë të njohur emrin e kandidatit, edhe pse publiku, në

masë të madhe, e perceptonte ose e aludonte se për kënd është fjala. Në rrethana të tilla u shkua në seancën konstitutive të Kuvendit të Kosovës pa marrëveshje. Vetëvendosje u soll e përgjegjshme në rrafshin shtetëror, duke mos e shtyrë, përmes makinacionesh të njohura nga viti 2014, seancën konstitutive të Kuvendit të Kosovës, kurse LDK-ja u tregua e përgjegjshme, duke e votuar Glauk Konjufcën për kryetar të Kuvendit të Kosovës.

**"Epoka e re":** Në bazë të ofertave të fundit të dy partive, është parë që pengesa kryesore për këtë marrëveshje është posti i kryetarit të Kuvendit. Kush duhet të lëshojë pe këtu?

**Kiçmari:** Kultura e përgjegjësisë shtetërore, që u shfaq në seancën konstitutive të Kuvendit të Kosovës nga LV-ja dhe LDK-ja, do të ishte me interes të pasohet edhe me hapa të tjerë. Të dy subjektet i lëvizën pozicionet fillestare përmes ofertave të reja. Por kjo lëvizje nuk krijoi masën e mjaftueshme të racionalitetit politik, për të vënë në zbatim, atë që në politikë është i domosdoshëm në raste të tilla: kompromisin. LV-ja propozoi shtimin e numrit të dy ministrive, gjë që rezultonte në një tejkalim me vetëdije të premtimit elektoral, për hir të drejtpeshimit përfaqësues, duke i njohur edhe mandatin LDK-së për ta propozuar emrin e presidentit. LDK-ja insiston në një situatë prapakthimi: dorëheqjen e kryetarit të Kuvendit, zgjedhjen e një kandidati të LDK-së për kryetar të Kuvendit deri në zgjedhjen e presidentit të Republikës. Në rrafshin e stabilitetit institucional, funksionimit demokratik të institucionit më të lartë ligjvënës dhe imazhit të Republikës së Kosovës, imponimi i dorëheqjes së kryetarit të Kuvendit nuk më duket zgjidhje e mençur. Kryetari i Kuvendit, sipas sistemit tonë kushtetues, është njeriu i dytë në hierarkinë shtetërore. Ai duhet të ketë imunitet të plotë institucional dhe funksional dhe nuk mund të bëhet, pas zgjedhjes së tij, objekt i lëvizjes për shkak të interesave partiake. LDK-ja e kishte këtë mundësi para seancës konstitutive, por nuk e shfrytëzoi. Madje Kushtetuta e Republikës së Kosovës ia garanton qartë partisë fituese detyrën e kryetarit të Kuvendit. Është në akord me një praktikë të njohur në shumë sisteme të demokracisë parlamentare. Ja një shembull identik: Aktualisht kancelarja dhe kryetari i Bundestagut në Gjermani janë nga CDU, kurse presidenti Federal është nga SPD-ja.

**"Epoka e re":** Nga ajo që keni parë deri më tani, cilat janë gjasat që të kemi një koalicion LV-LDK?

**Kiçmari:** Unë e quaj interes

nacional krijimin e një koalicioni qeverisës. Sa më parë aq më mirë. Vendi është duke u karakterizuar nga një mosstabilitet institucional prej shumë vitesh, por sidomos nga vera e vitit 2019. Mënyra se si u arnuar koalicioni qeverisës mandatin e kaluar, duke u dhënë shumë fuqi pushtetore partive mezi të përfaqësuar në parlament, flet për foshnjërinë politike të demokracisë sonë. LV-ja dhe LDK-ja e kanë shansin të krijojnë një realitet të ri demokratik dhe t'i vendosin bazat e një kulture të re demokratike. I inkurajoj që ta bëjnë këtë gjë! Interesi partiak duhet t'i lëshoj vendin interesit kombëtar, shtetëror dhe shoqëror. Besoj ende, se në të dy subjektet ka mendje racionale, që e kanë këtë gjë parasysh dhe në ditët e ardhshme do të dëgjohet zëri i tyre.

**"Epoka e re":** Vizita e emisarit amerikan në bisedimet Kosovë - Serbi, Richard Grenell, sa mund të ketë ndikim në formimin e këtij koalicioni?

**Kiçmari:** Emisari amerikan e tha publikisht se nuk është detyra e tij që të interferohet në bisedimet për krijimin e koalicionit. Në bazë të informatave që kam, ai i ka inkurajuar të dy subjektet për të hyrë në koalicion, por nuk ka bërë presion. Është një sjellje e kujdesshme e miqve tanë amerikanë. Mendoj se ambasadori amerikan në Kosovë, Kosnett, është duke luajtur një rol shumë pozitiv në këtë proces. Ambasadori Grenell duket t'i ketë marrë parasysh udhëzimet e tij. Lënia e subjekteve politike të Kosovës për t'i zgjidhur vetë situatat, pa presionin e jashtëm, është me interes për demokracinë në vendin tonë.

**"Epoka e re":** Cila duhet të jetë zgjidhja nëse këto dy parti nuk do të mund të bëjnë marrëveshje?

**Kiçmari:** Vendi duhet të ketë qeveri. Lënia e vendit pa qeveri edhe për muaj të tërë është gabim i madh. Interesi nacional, shtetëror dhe shoqëror determinon urgjentisht krijimin e qeverisë. Sidomos interesi shoqëror. Paramendojeni situatën, që vendi të mbetet pa qeveri efektive deri në prill. Buxheti nuk mund të miratohet. Qeveria aktuale nuk ka të drejtë legale për të dërguar draftligje në Kuvend. Vendi do të kalonte në gjendje insolvente. Pagat e shërbyesve civilë nuk mund të paguheshin. Shteti kollapson në rrafshin financiar. Natyrisht që nuk bëhet hataja nëse shkohet në zgjedhje të reja. Ka shumë raste të vendeve me stabilitet të qëndrueshëm demokratik, kur ndodhen para situatave të tilla. Por, është nevojë urgjente, që edhe në rast se shkohet në zgjedhje, paraprakisht të gjendet një zgjidhje legale, qoftë edhe e përkohshme, për të mos e sjellë në gjendje kolapsi funksionalitetin buxhetor.

# Sot pritet të rifillojnë takimet LV - LDK për formimin e qeverisë

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 24 JANAR** - Sot (e shtunë) pritet të takohen përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe ata të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për vazhdimin e negociatave për arritjen e një marrëveshje për bashkëqeverisje. Burime të gazetës "Epoka e re" brenda këtyre partive kanë bërë me dije se Albin Kurti dhe Isa Mustafa këtë të shtunë pritet t'i rifillojnë takimet pas një pauze disaditëshe. Ndërkaq të premtën rreth ecurisë së negociatave për formimin e qeverisë kanë folur përfaqësuesit e LV-së dhe të LDK-së.

Nënkryetarja e Lëvizjes Vetëvendosje, Fatmire Kollçaku-Mullhaxha, ka thënë se ka vullnet të dyanshëm politik që të arrihet një marrëveshje për bashkëqeverisje LV-LDK. "Ka vullnet të dyanshëm politik. LV-ja me bindje të plotë e them se ka qenë shumë korrekte. LV-ja, përkundër faktit se ka dalë e para, është subjekt fitues, ka pasur një partneritet të mirëfilltë me LDK-në. Ta kemi kryeministrin nga radhët tona dhe kryeparlamentarin. Presidenti ka qenë në fillim, ne nuk kemi pretenduar të jetë nga LV-ja. Tani jemi ku jemi, edhe një herë po e rikonfirmoj vullnetin e dy palëve. Të dyja palët janë duke bërë maksimalisht që të ndodhë edhe një takim. Shumë shpejt ky takim do të ndodhë", ka thënë Kollçaku-Mullhaxha. Kurse nënkryetarja e LDK-së, Vjosa Osmani, është shprehur se deri të dielën do të ketë një

epilog rreth marrëveshjes për formimin e qeverisë me LV-në. Osmani para selisë së partisë u tha gazetarëve të premtën se shumë shpejt do të ketë një takim ndërmjet kreut të LV-së, Albin Kurti dhe atij të LDK-së, Isa Mustafa. "Shumë shpejt do ta kemi takimin e radhës dhe natyrisht që shpresoj që aty do të bëhet përafrimi përfundimtar për çdo gjë që ka mbetur si mospajtim ndërmjet palëve. Shpresoj shumë që brenda pak ditësh të kemi një përgjigje dhe një epilog përfundimtar sa iu përket takimeve dhe bisedimeve ndërmjet LDK-së dhe LV-së", ka thënë Osmani, duke shtuar se është e rëndësishme që të arrihet kjo marrëveshje. "Është mirë që këto dy ose tri ditë të kemi lajme të mira për vendin. Unë besoj se varet shumë se çka ndodhë këto dy-tre ditë", ka deklaruar Osmani. LDK-ja deri më tani ka përsëritur kërkesën e saj që posti i kryeparlamentarit t'i takojë asaj.

Ditët e fundit është folur për mundësinë e dorëheqjes së Glauk Konjufcës nga posti i kryetarit të Kuvendit, por zyrtarë të LV-së kanë thënë se një gjë e tillë nuk pritet të ndodhë. Nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, ka thënë se çdo kërkesë për kthim prapa është shkelje e parimit të demokracisë, që cenon vullnetin e deputetëve. "Është e padrejtë dhe e papranueshme kërkesa për dorëheqjen e kryetarit të Kuvendit. Nuk ka asnjë arsye serioze dhe parimore se pse duhet të shqyrtohet një kërkesë e tillë", ka thënë Nagavci.



# Si të iket nga 'kultura e korrupsionit'?

PRISHTINË, 24 JANAR - Emërimet politike, fenomeni i nepotizmit dhe korrupsionit vazhdojnë t'i ngufasin institucionet e Kosovës dhe në përgjithësi shoqërinë, thuhet në raportet e organizatave ndërkombëtare dhe atyre vendore. Sipas raportit të organizatës Transparency International, që është publikuar të enjten, ku prezantohet Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2019, Kosova del se ka shënuar regres sa i takon luftës kundër korrupsionit.

Edhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare në Kosovë konsiderojnë se korrupsioni në Kosovë në masë të madhe është i shprehur kryesisht me emërimet e militantëve partiakë në poste të larta publike.

Arben Kelmendi nga Instituti Demokratik i Kosovës thotë për Radion Evropa e Lirë se tashmë është evidente se vetë partitë politike që kanë udhëhequr institucionet kanë krijuar një kulturë të korrupsionit, e cila është instaluar në të gjitha instancat qeverisëse në vend. "Kur një shoqëri është e korrumpuar, aty nuk paraqitet vetëm një lloj i korrupsionit. Në Kosovë kemi të bëjmë me disa lloje të korrupsionit, kemi korrupsionin e madh, pra atë të përmasave të mëdha ose që quhet korrupsioni i 'jakave të bardha'. Kemi atë korrupsionin e imtë, i cili paraqitet në nivele më të ulëta administrative. Sigurisht se nepotizmi dhe format e tjera të korrupsionit, pashmangshëm paraqiten në këto shoqëri, me të cilat në një

farë forme mbillet e ashtuquajtura kulturë e korrupsionit", thotë Kelmendi.

Organizata Transparency International në raportin e saj thotë se ajo që duhet të ndodhë në Kosovë është braktisja e praktikës së zakonshme e emërimeve politike në ndërmarrjet shtetërore, duke vendosur një detyrim të fuqishëm ligjor për partitë politike që t'i zbulojnë financat e tyre.

Kelmendi thotë se emërimet me preferenca politike dhe nepotizmi mund të çrrënjosen me instalimin e mirëfilltë të sistemit të meritokracisë. "Kjo dukuri shumë negative për shoqërinë kosovare do të mund të largohet vetëm me një instalim të mirë të sistemit të meritokracisë", vlerëson Kelmendi.

Edhe në Organizatën për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet "Çohu" thonë se kanë ngritur zërin disa herë për nivelin e lartë të korrupsionit dhe nepotizmit në institucione. Arton Demhasaj nga organizata "Çohu", duke folur për "Radion Evropa e Lirë", vlerëson se politika është ajo e cila i ka vendosur shtresat e korrupsionit në shumë institucione të rëndësishme. "Nga një qeveri në qeverinë tjetër, vetëm ka vazhduar avazi i vjetër. Secila parti që ka ardhur në pushtet është munduar që militantët e vet partiakë, e herë-herë edhe njerëz familjarë t'i sistemojë në pozita të ndryshme. Dhe, kjo ka ndikuar që ne sot ta kemi administratën shtetërore tërësisht të politizuar", thekson Demhasaj. Sipas tij, njerëzit e



politikës të vendosur në vendet e punës ku nuk e meritojnë, po ndikojnë negativisht në funksionimin e shumë mekanizmeve. "Krejt çka tash duhet, është vullneti politik i partive politike që ta ndalin praktikën e gabuar të deritanishme të emërimeve partiake të njerëzve të caktuar në pozitat e tilla. Duhet të funksionojë ideja që në pozitat e tilla të emërohen njerëzit që janë të thirrur", thotë Demhasaj.

Diplomatë ndërkombëtarë, fillimisht, por edhe shoqëria civile dhe në Prishtinë kanë tërhequr vërejtjen se korrupsioni ka ngufatur institucionet dhe ndërmarrjet publike më militan-

të partiakë dhe të afërm të familjes pa kriterë punësimi.

Përfaqësues të shoqërisë civile pohojnë se është paradoksale të besohet se nepotizmi mund të parandalohet nga subjektet politike që vetë e kanë instaluar nepotizmin në pozita vendim-marrëse dhe në institucionet shtetërore.

Ka rreth një vit që përfaqësuesit ndërkombëtarë në Kosovë i kanë shpeshuar kritikën në drejtim të institucioneve të Kosovës lidhur me fenomenet negative, si nepotizmi, korrupsioni apo për dukurinë, siç po quhet, të "kapjes së shtetit". Ata theksojnë se shtetet që Kosova i konsideron mike po e humbin durimin e tyre,

duke potencuar se qytetarët e Kosovës nuk e meritojnë një trajtim të tillë nga të zgjedhurit e tyre qoftë në nivelin qendror apo atë lokal.

Punësimet partiake dhe jo mbi bazën e meritave, sipas Ambasadës së Shteteve të Bashkuara dhe asaj të Britanisë së Madhe, ishin arsyeja kryesore pse përfaqësuesit e këtyre vendeve në vitin e kaluar janë tërhequr nga bordet e disa ndërmarrjeve publike. Së fundi, zyrtari nga Ambasada e ShBA-së është larguar nga bordi i Agjencisë për Krahësim dhe Verifikim të Pronës në Kosovë, duke konsideruar se në krye të këtij institucioni është një person i pakualifikuar.

## Ministri Bytyqi dhe përfaqësuesit e BB-së bisedojnë rreth ecurisë së projektit ESIP



PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të premtën përfaqësues të Bankës Botërore me të cilët ka biseduar rreth ecurisë së projektit ESIP "Përmirësimi i Sistemit Arsimit në Kosovë" të financuar nga Banka Botërore.

Angela Demas nga Banka Botërore e informoi ministrin se në këtë projekt, i cili ka qenë në rrezik të mbyllet si projekt gjatë pjesë së parë të vitit 2019, të gjitha objektivat janë arritur tashmë, në veçanti ka përfunduar me sukses ndarja e granteve zhvillimore për shkollat.

Përfaqësuesit e BB-së falënderuan stafin e MASHT-it, në veçanti kabinetin e ministrit Bytyqi dhe shefin e kabinetit, Baton Dushi, i cili ka bërë një punë të jashtëza-

konshme që gjërat të lëvizin pozitivisht dhe ky projekt i rëndësishëm për sistemin arsimor në Kosovë të vazhdojë të implementohet.

Ministri Bytyqi ka falënderuar Bankën Botërore për ndihmën që i kanë dhënë arsimit në Kosovë vazhdimisht, në veçanti për ndihmën e dhënë për implementimin e projektit ESIP si dhe për mirëkuptimin e treguar gjatë periudhës së vështirë të këtij projekti.

Ministri Bytyqi, po ashtu, ka falënderuar gjithë stafin e MASHT-it dhe BB-së që ka punuar në këtë projekt, ndërsa ka theksuar se do ta japë ndihmën e tij për aq kohë sa do të jetë në detyrë, në mënyrë që të realizohen edhe planet e parapara për këtë vit në kuadër të projektit.

# Përse nuk po krijohet Qeveria e Kosovës



**Bedri ISLAMI**

Megjithëse nuk ishte një fitore plebishitare dhe larg asaj që ishte prituri, përsëri, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, për shumëkënd, edhe për një pjesë të ndryshme të atyre që nuk e kishin votuar, ngjalli shpresë dhe krijoi një vorbull besimi edhe përtej Kosovës.

I nisur nga një lëvizje studentore, me ndalesë në burgjet serbe, ai krijoi Lëvizjen me emrin ndjellës, Vetëvendosje! dhe nisi një rrugë politike, e cila asnjëherë nuk ka qenë e qetë, por gjithnjë ka qenë mirë e artikulluar.

I vendosur përballë një etashmenti politik që po e humbiste veten përmes vendimeve të paqarta, rritje të korrupsionit, vrazhdësisë dhe krijimit të problemeve të njëpasnjëshme, Kurti pritej, në fakt ende e presin, të ishte lideri i duhur për Kosovën, për nxjerrjen e saj nga stanjacioni, vendosjen e shtetit të së drejtës, krijimin e një klime të barabartë për të gjithë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe nderimin e luftës çlirimtare. Mbi të gjitha, ai pritej, dhe ende pritet, që të ishte përballë politikës serbe me një qasje ndryshe, më të fuqishme, në thelb më nacionaliste, më të vendosur dhe asnjëherë të nënshtruar.

Deklaratat e tij politike në vite, pavarësisht kohës së bërë dhe tonit e, për më tepër, pavarësisht metodës agresive, ngjallnin dhe vazhdojnë të ngjallin mendimin se, patjetër, politika e Kosovës po futej në një stad të ri, shumë më domethënës dhe tejte më të afruar me aspiratat e shqipëtarëve. Votuesit e Kurtit, si ka ndodhur vetëm një dekadë më parë me Thaçin, shumica e votuesve janë të rinj dhe kjo e bën atë të ketë pas vetes një forcë energjike, të etur për ndryshime dhe të gatshme për përmbysje.

Fitorja e tij në zgjedhje ishte e prituri, vetë Kurti hyri në lojën elektorale me moton e kryeministrit të ardhshëm, ai gjeti partnerin e vetëm në këtë lojë apo paslojë, LDK-në e Isa Mustafës dhe, duke i bërë ftesën për një koalicion parazgjedhor, ku me siguri njerëzit e tij do të kishin epërsi, ai ishte i gatshëm të ndërtonte një qeveri të vogël, me gjithsejtë 12 ministri, nga të cilat dy janë për pakicat dhe serbët, po ashtu pakicë, të krijonte një aparat të thjeshtë, efikas, pa

humbje të mëdha dhe, sidomos, larg qeverisë në largim që kishte aq shumë zëvendësministra sa nuk kishte asnjë shtet në botë.

Tani është një situatë krejt tjetër nga sa ishte menduar. Premtimi i Kurtit për të ndërtuar maksimalisht shpejt një qeveri të re ka rënë. Askush nuk e kujton më atë. Kaluan tre muaj e gjysmë nga zgjedhjet politike në Kosovë dhe qeveria e së djeshmes është ende ligjërisht Qeveria e Kosovës, pavarësisht dorëheqjes së shefit të saj, Haradinaj.

Loja naive, thuhet fëmijërore, mes presidentit të Kosovës dhe liderit të LV-së, t'i kujton zemërimet fëmijërore, të cilët gjuhën me njëri-tjetrin për gjithçka dhe duket sikur në një çast po pajtohen me njëri-tjetrin kur, në fakt, e kanë stërritur distancën dhe ndasinë mes tyre.

Ka disa arsye përse Kosova është pa qeveri dhe përse është krejt e mundur që Kurti dhe LV-ja të mos mund ta krijojnë qeverinë e premtuar.

Në rrugëtimin e tij politik, Kurti dhe LV-ja kanë pasur gjithnjë përballë vetes kundërshtarë, të cilët, më tepër sesa kaq, ata i kanë trajtuar si armiq politikë dhe i kanë luftuar si të tillë, me të gjitha mjetet e fjalës dhe, herë pas here, edhe me molotovë apo me tymuese.

Në këtë rrugëtim, sa herë që njëri nga aleatët e djeshëm ka ndryshuar rrugë, Kurti dhe LV-ja i janë vërsulur rreptësisht, me të gjithë egërsinë e një politike skajore. Kjo ka ndodhur me LDK-në, kur Thaçi u zgjodh president edhe me votat e saj; ka ndodhur me AAK-në, kur ajo pranoi postet qeveritare de detyrën e kryeministrit, ka ndodhur me Nismën e Limajt, ndoshta më qetë, sepse nuk e ka trajtuar kurrë si forcë serioze dhe desh e nxori krejt jashtë lojës me votat e manipuluar të ardhura nga Serbia dhe, sidomos e, mbi të gjitha, me PDK-në, në dy kohët e saj, si në drejtimin e Thaçit, ashtu edhe në drejtimin e Veselit.

Normalisht, përafrimi më i madh i LV-së është me PDK-në, pasi kanë fillësia të përbashkëta, mentalitet të përbashkët, megjithëse PDK-ja synon të shfaqet si forcë e së djathtës, në fakt janë të dyja të majta; njerëzit e njerëz anë gjenden lehtësisht edhe në anën tjetër; si njëra ashtu dhe tjetra, në kohë të ndryshme kanë pasur synim bashkimin kombëtar dhe e kanë trajtuar shtetin shqiptar si vendin e tyre amë.

LV-ja dhe Kurti, në varësi të sjelljeve politike, i bënë të gjithë armiq. Shkuan përtej cilësimit si kundërshtarë, duke e përjashtuar çdo lloj bashkëpunimi me to. Adresa e vetme që u kishte mbetur ishte LDK-ja, krejt e

ndryshme me LV-në dhe kjo, jo se LDK-ja është forcë e së djathtës por, sepse, shumica e atyre që ishin dikur besnikë të Lidhjes Komuniste të Serbisë, kanë gjetur strehë në LDK, duke ia nisur që nga shefi i saj, Mustafa.

Përjashtimi i të gjithave dhe mbështetja në një gur ishte gabimi i parë dhe më themeltar. LDK-ja është vërtet, në shumicën e saj, një forcë politike e dalë nga Lidhja Komuniste e Kosovës, por është forcë politike që duhet llogaritur, u duhesh qasur gjithnjë me një opsion rezervë dhe nuk i duhen lënë kurrë të gjithë gurët në gjysmëfushën e saj.

E, megjithatë, edhe nëse Lëvizja dhe Kurti do të krijojnë më në fund një qeveri të përbashkët me LDK-në, që do të jetë si bashkimi i verës me uthullën, gjërat nuk do të jenë kurrë në dobi dhe jetëgjatësia e saj mund të varet nga fakti se si është zgjuar në mëngjes Isa Mustafa. Klanet brenda LDK-së dhe vetë lideri i saj nuk ia kanë harruar Kurtit protestat kundër tij dhe thirrjet masive "Isë, Isë, këlyshi i Serbisë". Kërkesa për të bërë qeveri me "këlyshin e Serbisë", duke ndjellë drejt tij edhe përkuljen, është shkak i dytë i moskrijimit të qeverisë. Sepse LDK-ja dhe Isa Mustafa nuk duan vetëm ndjelljen e përkuljes, por përkuljen e plotë. Deri në nënshtrim.

A do ta nënshtrijë Kurtin etja për pushtet? Kjo është pyetja që rëndon mbi të dhe të cilën askush nuk mund ta dijë me siguri përgjigjen e saj.

Ka shumë kohë, që në fillimet e bisedimeve për një qeveri të përbashkët që gjithçka, deri në banalizim, sillet rreth posteve qeveritare dhe shtetërore. Kaq bajate u bë kjo gjë saqë askush nuk e di nëse liderët, në kaq shumë takime, kanë folur edhe për gjëra të tjera, apo vetëm për ndarjen e tortës së pushtetit. Në ndejat e gjata nuk dihet nëse kanë folur për programe qeveritare, synime dhe objektiva, për qëndrimin që do të ketë qeveria e tyre lidhur me dialogun me shtetin serb, për krijimin e Zajednicës, bashkësive me shumicë serbe, ndaj idesë së të cilës Kurti ka qenë kundërshtar dhe Mustafa ka qenë pranues; rreth qëndrimit ndaj idesë së Minishengenit që Kurti nuk e pranon dhe Mustafa mund ta shohë si vazhdë e politikës së tij; rreth goditjes së kimit të organizuar, ku njëra palë, ajo që nuk ka qenë në pushtet, ndihet e qetë, ndërsa pala tjetër, ajo që ka shijuar disa herë pushtetin, ndihet e rrezikuar.

Përcjellja mes një politike që ka të bëjë me ndarjen e posteve, pra

të jap pesë dhe m'i prano pesë, ky është i imi dhe ky tjetri është i yti, për atë tjetrin do të diskutojmë më vonë... jo ai post është i imi... pra e gjithë kjo tollovi, që më shumë se politike, është foshnjore, ka sjellë humbjen e besimit se do të ketë një qeveri si ishte menduar por, edhe nëse do të ketë, sa do të jetë efikase?!

Nuk mjafton vetëm vullneti i një njeriu për të bërë një qeveri të mirë megjithëse, si duket, asnjëri e as tjetri nuk kanë dëshirë të kenë një qeveri të përbashkët, derisa t'i vjelin sa të munden dhe deri ku të munden përfitimet qeverisëse.

Prej shumë kohësh, edhe kur Haradinaj ende nuk kishte dhënë dorëheqje, lideri i LV-së, Kurti, kishte shpallur se ai do të ishte kryeministri i ardhshëm i Kosovës. Pak të thuash se kjo nuk është modeste. Të tjerë mund ta artikulonin emrin e tij, por ai vetë, sidomos kaq shpesh e herëherë pa vend, nuk duhej të binte në batakun e zakonshëm politik. Qeveria e përbashkët Kurti - Mustafa duket një mision i pamundur. Pas tyre qëndron hija e një njeriu që e njeh politikën më mirë se të dy, Thaçi, dhe, i cili, ose nuk i ka tërhequr fijet deri në fund, ose pritet ta ndërmarë aksionin e tij politik. Të besosh se e ke mposhtur Thaçin, se ashtu është dëshira jote, është naivitet fëmijëror, që nuk lejohet në politikë.

Presidenti i Kosovës i joshë të dy për një mandat, por askush nuk shkon ta tërheqë, megjithëse e duan. Loja me pushtetin bëhet edhe më e rëndë dhe, si duket, nuk e mbajnë dot, kur edhe përkrahja ndërkombëtare nuk është si është menduar se do të jetë. Fakti që ata, përfaqësuesit ndërkombëtarë, po bëjnë lojëra

fjalësh, duke përsëritur se presin krijimin e qeverisë, por nga një distancë jo e zakonshme, tregon se edhe te vetë ata apo kabinetet e tyre qeveritare ka pasur një prirje ndryshe.

Mustafa, edhe kur nuk ka qenë lideri suprem, si një ushtarak civil, i LDK-së, e ka ditur lojën politike dhe passkenat e saj. Këtë po luan edhe tani. Në këtë grackë - nëse është vetëm grackë - ka rënë edhe lideri i Lëvizjes, Kurti, që, duke bërë vetëm një zgjedhje, mund të mësojë se nuk thahen të gjitha burimet për të gjetur një burim të ri, i cili ende nuk dihet se çfarë uji ka.

Thirrja për lirinë, duke përdorur tonin e diktatorit, nuk është shenjë demokracie!

Edhe në politikën e tij ndaj Shqipërisë, jo rastësisht, Kurti bëri lëvizje të gabuara, duke u shfaqur si palë politike në një ndeshje që nuk ishte e tij dhe nuk mund të jetë e tij, pavarësisht filialit që ka krijuar në Shqipëri.

Mbështetja e tij ndaj lëvizjeve të Berishës apo të Metës, të pazakonta për një politikan të hapur, si kundërvënien ndaj qeverisë Rama, për më tepër në një çast kur presidenti i shtetit të tij, pavarësisht nëse e njeh apo jo ai vetë, ishte në përplasje me zotin Berisha, ku disa të vërteta po shpallëshin nga njeriu i lëvizjes klandestine çlirimtare, ishte mburoja që Kurti po i vendoste pa të drejtë njerëzve, që e kishin sulmuar egërsisht dhe do ta sulmojnë edhe në të ardhmen.

Nuk mjafton vetëm të shpallësh se ti do të jesh kryeministri i ardhshëm i Kosovës.


Duhet të bëhesh fillimisht dhe pastaj ta shpallësh. Se, si kudo, edhe në politikë, gjërat kanë rendin e tyre.



Në Kosovë nuk është regjistruar asnjë rast i prekur nga virusi '2019-nCoV' që ka prekur Kinën dhe i cili është përhapur edhe në ShBA, Tajlandë, Japoni dhe Republikën e Koresë

# IKShPK-ja ndërmerri masa për virusin e ri '2019-nCoV'

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar të premten se ka ndërmarrë të gjitha masat pas alarmit se në Kinë është përhapur një virus i ri, i emërtuar '2019-nCoV', i cili ua mori jetën 17 personave dhe që është përhapur edhe në ShBA, Tajlandë, Japoni dhe Republikën e Koresë. Raportohet se janë konfirmuar më shumë se 500 raste të personave të infektuar me këtë virus. IKShPK-ja ka bërë me dije se në Aeroportin Ndërkombëtar 'Adem Jashari' është ekipi mjekësor me të cilin janë në kontakt për mbikëqyrjen e situatës në rast të shfaqjes së personave të dyshimtë me këtë virus



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 JANAR - Më 31 dhjetor të vitit që lamë pas, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) është njoftuar për disa raste të pneumonisë në qytetin Wuhan, Provinca Hubei e Kinës. Virusit nuk përputhej me ndonjë virus tjetër të njohur. Kjo ngriti shqetësimin sepse kur një virus është i ri, ne nuk e dimë se si përhapet te njerëzit. Një javë më vonë, më 7 janar, autoritetet kineze konfirmuan se ata kishin identifikuar një virus të ri. Virusit i ri është një koronavirus, i cili është një familje e viruseve që shkakton rrufë të zakonshme (ftohje) si dhe virusin e SARS dhe MERS. Ky virus i ri u emërua përkohësisht '2019-nCoV'. OBSH-ja ka punuar me autoritetet kineze dhe ekspertë globalë që nga dita kur u informuam, për të mësuar më shumë rreth virusit, si ndikon te njerëzit që janë të sëmurë me të, si mund të trajtohen dhe masat parandaluese. Aktualisht rastet e infektuara në Kinë janë eksportuar në ShBA, Tajlandë, Japoni dhe Republikën e Koresë. Ky virus ua mori jetën 17 person-

ave në Kinë dhe raportohet se janë konfirmuar më shumë se 500 raste të personave të infektuar me këtë virus. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) përmes një komunikate për media tha se virusi është i rrezikshëm në rast të shfaqjes së komplikimeve të sëmundjes, sidomos për

personat me imunodeficiencë dhe sëmundje kronike. "Mundësia e përhapjes së këtij virusi ekziston në çdo vend, në rast të kontaktit me burimin e infeksionit siç janë personat që vijnë nga vendet e prekura me këtë virus. IKShPK-ja është duke

monitoruar nga afër epideminë e sëmundjes respiratore të shkaktuar nga një koronavirus i ri i identifikuar për herë të parë në Wuhan, Provinca Hubei, Kinë. IKShPK-ja, Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e rasteve gjatë tërë vitit, dhe përcjell situatën epidemiologjike. Instituti Kombëtar ka rekomanduar të të gjithë Drejtorët Rajonalë të Shëndetësisë Publike dhe punëtorët shëndetësorë që ta ngritin nivelin e vigjilencës dhe raportimit të rasteve të dyshimta në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private në Kosovë. Çdo rast i dyshimtë i sëmundjes duhet të raportohet nga Kujdesi Parësor Shëndetësor dhe institucionet e tjera shëndetësore publike dhe private, brenda 24 orëve (e dëshirueshme sa më parë që është e mundur me mjetin e komunikimit më të shpejtë) në Qendrat Rajonale të Shëndetësisë Publike dhe IKShPK", është thënë në komunikatën e IKShPK-së. IKShPK-ja ka bërë thirrje që të gjitha institucionet shëndetë-

sore të vazhdojnë ta zbatojnë gatishmërinë e tyre për emergjencat shëndetësore, në përputhje me Rregulloret Ndërkombëtare të Shëndetit (2005). "Instituti Kombëtar do t'i informojë rregullisht institucionet shëndetësore, Ministrinë e Shëndetësisë, Qendrën e Situatave dhe OBSH-në për ecurinë epidemiologjike të Novel Coronavirus (2019-nCoV) në Republikën e Kosovës. Në Aeroportin Ndërkombëtar 'Adem Jashari' është ekipi mjekësor, me të cilin jemi në kontakt të vazhdueshëm për mbikëqyrjen e situatës në rast të shfaqjes së personave të dyshimtë me sëmundje ngjitëse. Ekuipazhi i aeroplanit duhet t'i ndjekë procedurat operacionale të rekomanduara nga Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror (IATA) në lidhje me menaxhimin e personave të dyshimtë në sëmundjeve ngjitëse në bordin e aeroplanit. Deri më tani nuk është regjistruar asnjë rast i prekur nga ky virus në vendin tonë", është theksuar në këtë komunikatë.

## Masat e parandalimit

Shmangia e kontaktit të ngushtë me njerëzit që vuajnë nga infeksione akute të frymëmarrjes; larja e shpeshtë e duarve, veçanërisht pas kontaktit të drejtpërdrejtë me njerëzit e sëmurë ose në vendqëndrimin e tyre; shmangia e prekjes së fytyrës dhe mbulimi i gojës dhe hundës me faculetë, me mëngë ose parakrahë gjatë kollës dhe teshtitjes. Hidhni faculetat e përdorura në shportën më të afërt të mbeturinave. Nëse keni ethe, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore dhe tregoni historinë eventuale të udhëtimit jashtë vendit. Personat e sëmurë duhet të qëndrojnë në shtëpi në mënyrë që të parandalohet përhapja e sëmundjes. Të evitohen vendet e mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz. Personat të cilët kanë qenë në provincën Wuhan, Kinë brenda dy javëve të fundit dhe kanë ethe, kollë ose vështirësi në frymëmarrje, duhet menjëherë të kërkojnë ndihmë mjekësore.

## Rritet bashkëpunimi në mes të qytetarëve dhe ATK-së

PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Vazhdon të rritet bashkëpunimi në mes të qytetarëve dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), duke raportuar parregullsitë tatimore, evazionin fiskal, rastet korruprive, si dhe dukuritë e tjera negative që ndërlidhen me sistemin tatimor në Kosovë. "Në mënyrë që të luftohen këto dukuri negative, ATK-ja ka në dispozicion linjën pa pagesë 0800 80 800, si dhe kutitë e vërejtjeve, të cilat janë të vendosura në të gjitha zyrat regjionale të ATK-së, përmes të

cilave qytetarët mund të lajmërojnë për çdo parregullsi tatimore. Pikërisht nga raportimet e pranuar nga ana e qytetarëve, ATK-ja vetëm gjatë kësaj jave ka ndërmarrë aktivitete te linjat transportuese të udhëtareve me destinacion nga Prishtina në qytete të tjera të Kosovës. Aktivitetet në fjalë janë zhvilluar me qëllim që të verifikohen nëse këto linja janë të fiskalizuara dhe të konstatohet nëse pajisjet elektronike fiskale janë duke u përdorur", është bërë me dije në njoftimin e

ATK-së. Sipas ATK-së, në vitin 2019 përmes linjës pa pagesë 0800 80 800, si dhe përmes kutisë së vërejtjeve, ATK-ja ka pranuar 700 raste, të cilat kryesisht kanë qenë raportime për moslëshim të kuponit fiskal, evazion fiskal, si dhe sjelljeve jo të mira të zyrtarëve të ATK-së. "Të gjitha rastet e raportuara janë deleguar në regjionet përkatëse, për të cilat janë zhvilluar 483 aktivitete në terren, ku nga konstatimet e bëra janë lëshuar 370 gjopa në vlerë 202,167 euro. Qytetarët në vazhdimësi janë duke reflektu-



ar besim ndaj ATK-së, duke bashkëpunuar në mënyrë që të identifikohen rastet të cilat krijojnë shmangie tatimore,

korrupsion dhe keqpërdorim të detyrës nga ana e zyrtarëve të ATK-së", është thënë në njoftimin e ATK-së.



# Implementimi i parimeve të qeverisjes korporative do t'i fuqizonte ndërmarrjet private

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 24 JANAR - Integrimi i parimeve të qeverisjes korporative në ndërmarrjet private, ndikimi i këtyre parimeve në tërheqjen e investimeve të huaja direkte dhe në përmirësimin e menaxhimit të bizneseve ishin temat të cilat u diskutuan në punëtorinë mbi qeverisjen korporative të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Leonora Kusari, menaxhere kryesore në Zyrën për Këshillime për Ndërmarrjet e Vogla në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, ka deklaruar se qeverisja korporative është shumë e rëndësishme për institucionin pjesë e të cilit është ajo, sepse rrit mundësitë për investime në biznes. Sipas saj, disa nga përfitimet që dalin nga aplikimi i standardeve të qeverisjes korporative janë rritja e vlerës së aseteve, qarkullimit, produktivitetit

dhe fitimit të kompanisë. Ajo ka shtuar se në vendet e Ballkanit ka ngecje në zhvillim ekonomik, pikërisht për shkak të mosimplementimit të qeverisjes korporative. Kusari i ka rekomanduar sektorit privat që t'i implementojë këto praktika në mënyrë që ndërmarrjet të përfitojnë më shumë, të ketë më shumë tërheqje të investitorëve si dhe zhvillim më të madh ekonomik në vend. Kurse Alban Zogaj, ekonomist dhe specialist i monitorimit dhe vlerësimit, ka folur për gjendjen e qeverisjes korporative në ndërmarrjet kosovare. Sipas tij, është pozitiv fakti që në Kosovë një pjesë e ndërmarrjeve të mëdha kanë filluar t'i zbatojnë parimet e qeverisjes korporative në kompanitë e tyre, megjithatë, duke marrë parasysh faktin që në vendin tonë shumica e ndërmarrjeve janë të vogla dhe të mesme, qeverisja korporative ende mbetet një koncept i ri. Zogaj, gjithashtu, ka prezantuar disa prej të gjeturave të



studimeve të kryera nga Instituti "Rinvest", me ç'rast ka theksuar se Kosova ende nuk ka infrastrukturë ligjore që obligon kompanitë t'i implementojnë parimet e qeverisjes korporative. Visar Dobrosi, partner drejtues në "Recura Financials", ka folur për katër shtyllat e qeverisjes kor-

porative të cilat përfshijnë llogaridhënien, përgjegjësinë, transparencën dhe korrektësinë, të cilat, sipas tij, janë tejet të rëndësishme për zhvillimin e qeverisjes korporative në ndërmarrje. Dobrosi më tutje ka deklaruar se në gjashtë vitet e fundit në Kosovë ka përparim shumë të

madh sa i përket ngritjes së vetëdijesimit në lidhje me qeverisjen korporative, mirëpo ende mbetet shumë për t'u bërë për zbatimin e aspekteve të saj. Sipas tij, implementimi i praktikave më të mira të qeverisjes korporative ndikon edhe në rritjen e vlerës së ndërmarrjeve.

## Gërzhali: Sikur të kishte politikan vizionar taksa do të hiqej para vizitës së Grenellit



EPOKA  
ERE

**A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 24 JANAR - Sekretari gjeneral i Chamber Investment Forum - WB6, Safet Gërzhaliu, ka thënë se Kosova po të kishte politikanë të dijes dhe me vizion, atëherë është dashur ta hiqnin taksën para se i dërguari i posaçëm i presidentit Donald Trump për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, të udhëtonte në Beograd. Ai ka thënë se një veprim i tillë do ta fuqizonte pozitën negociuese të Kosovës në raport me Serbinë. "Sikur Kosova të kishte politikanë të dijes dhe vizionarë, që luftojnë për shtet e jo për pushtet, për hir

të kontributit të dhënë nga ShBA-ja dhe shtetet mike evropiane për çlirim dhe pavarësinë e Republikës së Kosovës, ambasadorin e ShBA-së në Gjermani e kishin 'armatosur' me heqjen e taksës para udhëtimit në Beograd, me qëllim të fuqizimit të pozitës së tij negociuese me krerë politikë në atë vend. Pasi do të duhej të dëshmohej fuqia e tij në takime, por edhe të forcohet pozicioni i ShBA-së në rajon, Evropë dhe më gjerë", ka thënë Gërzhaliu për "Epokën e re". Ai ka pohuar se tek ne politikanët lutën të jetojnë me të kaluarën, duke ngulfatur të ardhmen e Republikës së Kosovës.

## Drejtorit të Doganës i vazhdohet mandati edhe për tri vjet

PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ia ka vazhduar mandatin edhe për tri vjet të tjera drejtorit të përgjithshëm të Doganës së Kosovës, Bahri Berisha. Këtë e ka bërë me dije vetë Haradinaj përmes një shkrimi në profilin e vet në "Facebook". "Në

kuadër të kompetencave të mia kushtetuese dhe ligjore, sot drejtorit të përgjithshëm të Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, ia kam vazhduar mandatin edhe për tri vjet të tjera. Z. Berisha përgjatë shërbimit të tij në këtë pozitë ka dëshmuar profesionalizëm dhe korrektësi dhe me seriozitet ka kryer

punët dhe përgjegjësitë në këtë institucion shumë të rëndësishëm të vendit. Z. Berisha i uroj punë të mbarë edhe për vitet e tjera!", ka shkruar Haradinaj. Bahri Berisha u emërua në postin e drejtorit të përgjithshëm të Doganës së Kosovës në shkurt të vitit 2017.



# Ismajli thotë se komuna e Shtimes angazhohet për ambient sa më të pastër

SHTIME, 24 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Shtimes, Naim Ismajli, ka pritur në takim Dukagjin Hetemin, kryeshf i Kompanisë Regjionale të Pastrimit "Pastërtia" në Ferizaj, shoqëruar nga Osman Muharremi, përgjegjës i njësisë "Higjiena" në Shtime, Halil Halili, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike si dhe Lumni Amrushi, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Qëllimi i këtij takimi ka qenë informimi rreth grumbullimit të mbeturinave në komunën e Shtimes, ku ka pasur pajtueshmëri që kjo komunë të kontribuojë për ngritjen e kapaciteteve vepruese të kompanisë "Pastërtia".

Kryetari Ismajli ka thënë se janë zotuar që t'i menaxhojnë mbe-

turinat në mënyrë sa më të qëndrueshme. "Ne do t'i ndërmarrim hapat e nevojshëm për të investuar në mënyrë të planifikuar në sistemin e menaxhimit dhe se planifikimi i tillë do ta përmirësojë gjendjen e menaxhimit të mbeturinave dhe, përfundimisht, do të ndikojë edhe në gjendjen mjedisore në komunën tonë. Jemi duke bërë përpjekjet për të krijuar një ambient sa më të pastër për qytetarët tanë, mirëpo kjo mund të arrihet vetëm në bashkëpunim të plotë me të gjithë aktorët dhe qytetarët tanë", ka thënë Ismajli. Në këtë takim është vendosur që grumbullimi i mbeturinave në fshatin Pjetërshicë të fillojë më 31 janar, si dhe shumë shpejt do të përcaktohet orari edhe për të gjitha vendbanimet e tjera në komunën e Shtimes.



## Nënshkruhet marrëveshja për promovimin e prodhimtarisë bujqësore në Dragash

DRAGASH, 24 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Dragashit, Shaban Shabani, ka nënshkruar një marrëveshje me Caritasin zviceran për promovimin e prodhimtarisë bujqësore të kësaj komune. Sipas kësaj marrëveshje, Caritasi zviceran do ta zbatojë projektin "Prosperiteti i prodhimtarisë agrare në Kosovë nga investimet e qëndrueshme rurale - Pasuri" duke synuar për-

mirësimin e kushteve jetësore të fermerëve, rritjen e gjenerimit të të hyrave dhe prodhimin bujqësor në Dragash.

Marrëveshja në fjalë parasheh të investohen 57 mijë euro gjatë këtij viti në sektorin e prodhimtarisë. Me këtë rast, kryetari Shabani është shprehur se Komuna e Dragashit ka pasur një bashkëpunim të mirë me Caritasin zviceran. Ai ka thënë

se një bashkëpunim i tillë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ndërsa Veton Ruka dhe Nderim Pasuli nga Caritasi zviceran kanë vlerësuar lart bashkëpunimin me Komunën e Dragashit. Me rastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje ka qenë i pranishëm edhe Flamur Sylejmani, udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

## Vazhdojnë punimet infrastrukturore në Kobajë të Prizrenit

PRIZREN, 24 JANAR (ER) - Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Levent Kasemi, me bashkëpunëtorë, kanë inspektuar punimet infrastrukturore të cilat janë duke u zhvilluar në fshatin Kobajë të Prizrenit. "Në kuadër të ndërtimit të infrastrukturës rrugore në rrugët lokale në Kobajë po zhvillohet faza e dytë e punimeve,

ku po bëhet shtrimi i disa rrugëve në këtë fshat me kubëza betoni dhe skajore në gjatësi 1 280 metra, si dhe sipërfaqe 6 400 metra katrorë. Komuna do t'i vazhdojë edhe më tutje investimet e tilla në mënyrë që t'i përmbushë kërkesat e banorëve me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për jetë", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



## Muharremaj premtot rregullimin e dyshemesë dhe sallën sportive në shkollën "Shkëndija"

Suharekë, 24 janar (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka vizituar të premtot nxënësit dhe mësuesit të Mesme të Ulët "Shkëndija", ku nga afër është njoftuar me kushtet në të cilat punohet në këtë shkollë.

Kryetari Muharremaj pasi ka parë të arsyeshme rregullimin e

dyshemesë për kushte më të mira të nxënësve të këtushëm dhe rregullimin dhe funksionalizimin e sallës së sporteve, ka premtuar se të dyja këto do të rregullohen për një kohë sa ma të shkurtër. Ai, po ashtu, ka premtuar edhe përkrahjen për rregullimin e ambientit shkollor, përkatesisht oborrit të shkollës. "Do të veprohet për rregullimin e

dyshemesë ngaqë nxënësit duhet të kenë kushte më të mira gjatë mësimi. Po ashtu, u kam premtuar edhe rregullimin e sallës sportive brenda shkollës me kushte adekuate. Kemi biseduar edhe për projekte të tjera dhe për ambientin në oborrin e shkollës, të cilat do të shihen në realitet me angazhimin tonë të përbashkët", ka thënë Muharremaj.



Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (10)

# Magnetizimi i materialeve feromagnetike



**Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan**

E marrim një pjesë të materialit feromagnetik, përkatësisht të hekurit dhe e vendosim në brendësi të një solenoidi nëpër të cilin kalon rryma elektrike me intensitet (I). Përmes ngritjes së tensionit të rrymës elektrike, rritet edhe intensiteti i fushës magnetike brenda solenoidit. Në këtë mënyrë brenda solenoidit krijohet një fushë magnetike simetrike me polet (?s) dhe (?s). Në këtë rast fenomenet (ct) nga fusha magnetike pranojnë energji, dhe e rrisin nivelin energjetik të këtyre fenomeneve brenda grimcave elementare. Në këtë mënyrë këto grimca kalojnë në grimca vetërigjeneruese dhe transferuese dhe fillojnë të riprodhojnë dhe transferojnë mikrogrimca të ndryshme

grimcat (?). Shiko figurën 13. Këto mikrogrimca (?) pasi të riprodhohen nga protonet kanë një nivel energjetik të rritur nga i nënshtrohen drejtimit të fushës magnetike dhe orientohen në drejtim të polit magnetik (?s) të solenoidit. Mikrogrimcat (?) ndryshojnë tërësisht nga dipolet e zakonshme magnetike që i njih fizika e tanishme, sepse këto dipole magnetike të riprodhuara mund përmbajnë në brendinë e tyre dy fusha magnetike (?f?) dhe (?f?). Pasi të burojnë nga poli magnetik (? 1) fushat magnetike (?f?) ka intensitet më të lartë se fusha (?f?). Kurse fushat magnetike të këtyre dipoleve kanë drejtime të kundërta me njëra tjetrën. Por këto dipole magnetike kanë aftësi me i ndryshe edhe intensitetin e fushave magnetike dhe në raste emergjente kanë aftësi të barazojnë edhe intensitetin e tyre (?f?) = (?f?).

## Mikrogrimcat primare (? ) delta

Ngjashëm sikur te protonet edhe te elektronet, sapo fenomenet (ct) të marrin

## Mikrogrimcat primare (? ) ni

Ngjashëm sikur në dy rastet e mëparshme edhe fenomenet (ct) te neutronet kur pranojnë energji të caktuar nga fusha magnetike e solenoidit, e rrisin nivelin energjetik në vlerën (z)'n. edhe këto neutrone në këtë rast shndërrohen në vetërigjenerator, dhe fillojnë të prodhojnë mikrogrimca (?). Këto mikrogrimca ndryshojnë tërësisht nga mikrogrimcat (?) dhe (?). Pasi neutronet janë neutrale, për shkak të nivelit të ulët energjetik të fenomeneve (-c) dhe (t) brenda strukturës së neutroneve, dhe rrotullimin fenomeneve (-c) dhe (t) të tyre në drejtime të njëjta, nuk mund të quhen dipole magnetike. Por kanë mjaft ndikim te fushat magnetike, sepse e rrisin shpejtësinë e daljes nga të dy polet magnetike (?1), (?2) të mikrogrimcave (?) dhe (?). Pasi niveli energjetik i fenomeneve (-c) dhe (t) te neutronet është shumë më i ulët se te protonet, edhe pasi të riprodhohen anojnë nga mikrogrimcave (?), duke iu bashkuar, pastaj burojnë

ca (?),(?) dhe (?), të cilat kanë një nivel energjetik të ndryshëm me vetë protonet, elektronet dhe neutronet. Gjithashtu vlen të theksohet se materiali i cili është vendosur në fushën magnetike të solenoidit, pasi të magnetizohet në rastin tonë mbet një magnet permanent me një nivel të caktuar energjetik, i cili gjithashtu shndërrohet në vetërigjenerator i mikrogrimcave (?),(?) dhe (?). Mikrogrimca pasi të burojnë nga polet magnetike (?1) dhe (?2) asnjëherë nuk kthehen në polet magnetike të magnetit permanent, por shpërndahen në formë sferike rreth magnetit, duke e formuar një balon me rreze të caktuar. Rrezja e këtij baloni të mikrogrimcave vije duke u rritur në raport me kohën dhe nivelin energjetik të këtyre mikrogrimcave ashtu sikur shihet në figurën 14. Fushat magnetike e magneveve permanente është fushë me një nivel energjetik më të ulët se sa fusha në të cilën është magnetizuar. Kurse fushat magnetike që krijohen nga rryma elektrike mund të jenë fusha magnetike natyrale dhe fusha magnetike artificiale.

netike natyrale te trupat qiellorë në momentin kur krijohen quhen fusha magnetike primare (FMP).

## Fusha magnetike primare te trupat qiellorë

Fusha magnetike natyrale primare te trupat qiellorë, është fusha magnetike që buron drejtpërsëdrejti nga polet magnetike (?1) dhe (?2) të atij trupi qiellorë. Do të thotë këto fusha magnetike primare burojnë në çastin kur tornadoja elektromagnetike në një formë a tjetrën e krijon rrymën elektrike, nga e cila formohet fusha magnetike primare. Në këtë nivel fushat magnetike mund të mbesin edhe miliarda vite. Fushat magnetike primare janë tejet të rrezikshme për shëndetin e njeriut, dhe sjellin pasoja të pa parashikueshme për jetën e njeriut. Një fushë magnetike primare që buron nga trupat qiellorë mund ti tejkalojë (x) here, fushat magnetike të nivelit që përdoren sot në mjekësi e siç quhet në Francë (IRM) apo në Kosovë (RM) rezonancë magnetike.

## Fushat magnetike natyrale

Fushat magnetike natyrale konsiderohen ato fusha që krijohen përmes proceseve natyrore. Këto fusha zakonisht janë krijuar, dhe krijohen te trupat qiellorë përmes tornados elektromagnetike e cila është sqaruar në botimet e epoka e re 2019. Intensiteti i tyre varet nga niveli energjetik i fenomeneve (ct) që i shkaktojnë këto fusha magnetike natyrale. Si shembull kemi fushën magnetike të diellit, tokës, jupiterit, saturnit, uranit e neptunit, e kështu më radhe deri te galaksia, miniuniversi apo universi. Fushat mag-

## Fushat magnetike artificiale

Këto fusha magnetike artificiale kanë nivele të ndryshme, dhe krijohen nga njeriu përmes metodave të ndryshme që përdoren thuajse në të gjitha fushat e jetës, duke e përfshi edhe fushën e mjekësisë, ashtu sikur e cekëm më lartë rastin e (RM) rezonancës magnetike. Gjithashtu edhe këto fusha magnetike kanë nivelin e magnetizimit, dhe burojnë drejtpërsëdrejti nga polet magnetike qoftë të magnetit permanent apo polit të fushave magnetike të krijuara nga rrymat elektrike. (VIJON)




figura 13

duke filluar nga riprodhimi i mikrogrimcat primare (?) beta. Grimcat si protonet, neutronet ashtu edhe elektronet kur e ndërrojnë nivelin energjetik, pos që kthehen në rigjenerator kanë aftësinë që ta transferojnë një pjesë të nivelit energjetik nga njëra grimcë në grimcën e tjetër, por sido që të jetë grimca me natyra të njëjta.

## Mikrogrimcat primare (? ) beta

Prandaj rritja e nivelit energjetik në vlerën (x)'n përkatësisht ndryshimi i nivelit energjetik te fenomenet (ct) te protonet i kthen në protone vetërigjeneruese dhe transeferuese. Protonet vetërigjeneruese dhe transferuese mbesin në brendësi të atij materiali i cili është vendosur në fushën magnetike, figura 13, por nga poli i parë i magnetit (? 1). Fillojnë të burojnë mikro-

energji nga fusha magnetike e solenoidit dhe e rrisin nivelin energjetik në (y)'n kthehen në rigjenerator të mikrogrimcave (?). Këto mikrogrimca janë gjithashtu dipole magnetike, të cilat burojnë nga poli magnetik (?2) që është i orientuar në drejtim të polit magnetik (?s) të solenoidit. Këto ngarkesa përkatësisht këto dipole magnetike ndryshojnë jo vetëm nga dipolet magnetike që i njih fizika e tanishme, por ndryshojnë edhe nga ngarkesat përkatësisht dipolet magnetike (?). Gjithashtu këto mikrogrimca në brendinë e tyre përmbajnë gjithashtu dy fusha (?f?) dhe (?f?). Pasi të burojnë nga poli magnetik (?2) fushat magnetike (?f?) kanë intensitet më të lartë se fushat (?f?). Por këto mikrogrimca kanë aftësi për të ndërruar edhe intensitetin e fushave të tyre, dhe në raste emergjente kanë aftësi të barazojnë edhe intensitetin e tyre (?f?) = (?f?).

njëkohësisht nga poli magnetik simetrik (?1) dhe orientohen në drejtim të polit magnetik (?s) të solenoidit, ngjashëm sikur grimcat (?). Meqenëse këto mikrogrimca (?) nuk janë të ngarkuara, dhe nuk posedojnë fusha në vete, prapë se prapë duke pasur parasysh se në brendinë e tyre posedojnë elemente(-aX) dhe (-aY) të kundërta me fenomenet (ct) të protoneve dhe elektronet, kur dalin jashtë polit magnetik (?1) e rrisin distanca e tyre me mikrogrimcat (?) dhe(?).

## Fusha magnetike simetrike e magnetik simetrik

Pasi në rastin e mëparshëm sqaruam kalimin e atomit të materialet feromagnetike në vetërigjenerator, me ç'rast protonet, elektronet dhe neutronet riprodhojnë mikrogrim-




Fig14

# 'Lëkurëharta ime', një vepër për fatin e kombit tonë



Flamur MALOKU

Miku im, prof. dr. Adem Zejnullahu, me të cilin pata fatin të njihesha para disa vitesh në Institutin Albanologjik, kur punoja në një projekt shkencor të profesor Zymer Nezirit, këtë javë nxori nga shtypi librin "Lëkurëharta ime". Me këtë libër me poezi profesor Zejnullahu opusit të vet krijues, prej dhjetëra veprash shkencore dhe letrare, i ka shtuar vlerën dhe dimensionin poetik, estetik dhe historik.


Njëqind e nëntë poezitë e librit "Lëkurëharta ime" profesor Zejnullahu i ka shpërndarë në këta pesë cikle: "Lëkurëharta ime", "Urtia të mos humbë udhë", "Në këtë shekull të ri", "Mall vendlindje", "E bukura jeton pak". Por, para këtyre cikleve ka vënë vjershën e gjatë "Programatike", në të cilën paraqiten disa prej motiveve në jetën e autorit, për realizimin e të cilave është përpjekur kohë të gjatë ndër vite. Ndërkaq, në fund të librit ka radhitur pasthënien e prof. dr. Faik Shkodra shkruar për librin, në të cilën ka analizuar hollësisht poezitë, duke bërë krahasim të poezisë së tij që, për nga niveli estetik, ngjasojnë me poezitë e poetëve Jakup Ceraja, Rrahman Dedja, Ali Podrimja, Agim Vinca, Din Mehmeti, Rexhep Elmazi.

Në librin "Lëkurëharta ime" profesor Zejnullahu shpreh, me fjalë dhe figura të fjalëve, dhembjen tonë të përbashkët, të popullit shqiptar, që Konferenca e Londrës e deri në ditët e sotme, që ende nuk dihet qartë fati i Mitrovicës Veriore, për të cilën, sa herë që e zë ngoje, ndien dhembje dhe shpreh revoltë. Ndërkaq, mall dhe trajtim të temës historike dhe të fatit të keq shpreh për Çamërinë, fatin

e së cilës nuk e harron kurrë. Autori, për fatin e popullit shqiptar, të shpërndarë në disa shtete, për padrejtësitë e shumta që i janë bërë atij, i vërsulet Evropës, të cilën e quan "hileçare e kohëve të mugëta", së cilës e di që nuk i ka asnjë borxh të palarë, prandaj edhe kërkon që fati dhe territori i shqiptarëve të trajtohet ndryshe nga ajo. Kjo brengë e poetit dhe ky reagim i tij përcillet edhe në poezinë "Arbërisht". Megjithatë, jo në gjithë librin Zejnullahu përballet me të kaluarën. Jo në gjithë librin e tij trajtohen tema historike, fati i popullit, i shtetit dhe i kombit. Në poezitë e tij ka tema edhe nga përditshmëria jonë, nga pushimet buzë detit të Ulqinit, ashtu siç ka edhe poezi kushtu-

ar Isa Boletinit, tërmetit të fundit të ndodhur në nëntor 2019 në Shqipëri, shumimit të qenve të shumtë endacakë në kryeqytet dhe rrallimit të njerëzve të njerëzishëm.

Profesor Zejnullahu nuk është i ri, por ai shkruan poezi për shekullin e ri, edhe për atë dhe ata të vjetrit (sidomos për Motin e Madh). Është një vrojtues motivesh dhe temash sociale të cilat i letrarizon, të cilave u jep kuptim filozofik dhe etik. Ai e di çfarë ka ndodhur para pesëqind vjetësh në gjeografinë shqiptare, çfarë ka ndodhur për tre-katër shekuj me radhë në truallin ilir dhe çfarë ka ndodhur para 21 vjetësh në Kosovë. Prandaj, jo dhe pa një qëllim librit i ka vënë titullin "Lëkurëharta ime", e cila i ka



shërbyer, ashtu sikurse mua faqet për këtë këndvështrim, për t'i shkruar të ndodhurat e popullit të tij, sidomos fatkeqësitë e shumta, të cilët na fton t'i kujtojmë gjithmonë dhe t'i trajtojmë në vepra edhe të natyrës së poezisë lirike, njëkohësisht të përpiqemi, me mish dhe shpirt, që copat e ndara të Shqipërisë Etnike t'i bashkojmë në një, dikush prej nesh me kontribut letrar, dikush tjetër me kontribut politik.

Po e ndërpres këtë këndvështrim këtu, të cilin më shumë e ofrova si një lajm për një libër të ri të një studiuesi të vyeshëm e poeti të shquar, për ta vazhduar variantin e gjatë të shkrimit në librin me recensione dhe kumtesa që po bëj gati për shtyp.

## Shënime për autorin

Prof. dr. Adem Zejnullahu, studiues i letërsisë gojore dhe i letërsisë së shkruar shqipe, shkrimtar, profesor universitar. Ka lindur në Banjaskë, komuna e Vushtrrisë. Kreu shkollën normale, studimet e larta të gjuhës dhe të letërsisë shqipe në

Universitetin e Prishtinës (1972); po aty studimet pasuniversitare, ku mbrojti doktoratën në shkencën filologjike (1986). Deri më 1982 punoi mësimdhënës i gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollën të ndryshme të Prishtinës dhe në Mitrovicë. Prej vitit 1982-2010 punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në fillim hulumtues i pavarur, këshilltar shkencor dhe përgjegjës i Degës së Folklorit për disa vjet. I është kushtuar studimit të krijimit të gojore dhe prozës së shkruar, këngëve popullore historike dhe baladave popullore. Ka botuar monografi dhe vepra studimore për folklorin dhe letërsinë shqipe.

Ka shkruar dhe përgatitur mbi 30 vepra nga fusha e folklorit, kurse është autor i 500 njësive bibliografike, studimeve, trajtesave, artikujve, recensioneve për probleme të ndryshme nga fusha e folklorit dhe nga letërsia e shkruar.

Profesor Zejnullahu është fitues i shumë shpërblimeve letrare për poezi dhe për vepër jetësore. Poezitë e tij janë përkthyer në disa gjuhë të huaja.

## BABËZISË

Bashkë jetojmë  
Po qejfin  
S'dua të ta bëj

Troç ta them  
Unë rrokullis gurë  
Prishi paqe

## EVROPË

Hiliçare e kohëve të mugëta  
Nëpër leqe  
Nëntë dredhë m'i nxore  
Nga shpina e regjur  
Në shekuj çalamanë

Në qafë më ke lidhur lak  
E nuk t'kam  
As hile as hak!

Xhelai me sëpatë  
Pret koka në cung  
Zihet e zgërdhiet  
E ti me pahir  
Bën sehir!


Evropë, moj Evropë  
Që një shekull plagët kullojnë gjak  
Ku e humbe çekanin e drejtësisë, ore?!

(25.3.1999)

# Etemaj boton monografinë për Lëvizjen e Pajtimit të Gjaqeve

PRISHTINË, 24 JANAR - Publicisti Lulëzim Etemaj, një prej nis-mëtarëve të Lëvizjes për Pajtimin e Gjaqeve (1990-1991), ka dorëzuar në shtyp monografinë "Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë (1990-1991)", e cila do të dalë nga shtypi në fillim të muajit shkurt, kur kjo lëvizje mbushë 30 vjet nga themelimi. Sipas botuesit të këtij libri, Berat Armagedoni, Lulëzim Etemaj, ka ruajtur, ka

mbledhur dhe ka prezantuar letra, fotografi, faksimile dhe ka punuar gjatë dhe me pedanteri shkencore për ta publikuar këtë libër, i cili është i pari për Lëvizjen për Pajtimin e Gjaqeve (1990-1991), e që publikohet me rastin e 30-vjetorit të kësaj lëvizjeje, e cila shoi hasmëritë mes shqiptarëve edhe në Kosovë, edhe përtej saj. "Autori e ka kryer punën e vet. Edhe ne, po ashtu, së



bashku me disenjatorin dhe faqosësin Adnan Asllani. Tash po e dorëzojmë në shtyp. Nga data 2 shkurt do ta gjeni në të gjitha libraritë e Prishtinës, por edhe në Prizren, Ferizaj, Pejë, Gjakovë, Skenderaj,

Mitrovicë, Klinë... do të shpërndahet edhe përtej Kosovës. Do t'u bjerë në dorë jo vetëm atyre trimave që ngrenë gishtin e krimit, por dhe sidomos atyre që shtrinë dorën e pajtimit, të cilëve

edhe u kushtohet: Të gjithë atyre zemërgjerëve, që shtrinë dorën e pajtimit", ka shkruar Armagedoni në një njoftim që ka bërë në llogarinë e vet në rrjetin social "Facebook".

## YLLI MECE

### POSHTË URËS ATY MBI LUMËBARDH (Mitrovicës së plagosur)

*Shëëëëët... e plagosur po fle një urë,  
mbi kurrizin e kohëve të marra  
me armë, helmata e tela fort në të dy skajet  
këmbë e kokë lidhur kanë trupin  
Përgjumësh "qyteti somnambul" gdhiet pa qejf  
me ëndrra të ndara...  
Lumbardhi edhe pse i turbullt devijon  
e kokulur ecën për ta fshehur turpin*

*Asnjëherë s'patë ndodhur që mbi një urë  
të ulej ashtu dhe vetë Evropa  
Për ndokënd do të ngelet mister  
dhe të vërtetën akoma ndoshta nuk e dinë  
Veç në këmbët e saj dikush shkroi në shqip:  
Unë jam vetë revolta  
Shpirti s'përgjysmohet një pjesë për shqiptarët  
dhe diçka për Serbinë*

*Shëëëëët... po fletë barrikadat e lodhura  
nga pesha që mbartin  
(belbëzon me vete historia: E rrallë kjo,  
për të mos thënë kurrë!)  
Zgjoheh fëmijët prej dy anëve e nga pagjumësia  
gojë e tyre hapin  
Pranë urës mbi Ibër sodit Evropa  
fushëbetëjën e fëmijëve me gurë*

*Shëëëët... ju lutem pak qetësi  
përballen matanë urës dy lapidarë  
Shkruar te njëri dëshmor lirie  
po aq dhe tjetri plot invadorë  
Histori të tillë më besoni  
Globi kurrë në shekuj s'ka parë  
Heronj dhe pushtues luftojnë,  
dhe në monument me armë në dorë*

*Ti qesh e zgërdhiesh Evropë,  
sikurse qesh në Londër vite qemoti  
Vallë a nuk e ke kuptuar se poshtë urës mbi Lumbardh  
po spati paqe, ka fuçi baroti*

## Galeria e Ministrisë së Kulturës për zgjedh Programin Artistik për vitin 2020

PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Në bazë të konkursit publik për Programin Artistik të Galerisë së Ministrisë së Kulturës për vitin 2020, i cili ka qëndruar i hapur nga data 01.10.2019-11.11.2019, për të qenë pjesë e repertorit të GMK-së për vitin 2020, kanë aplikuar rreth dyzet artistë/e vendës nga rajoni dhe më gjerë nga Evropa e Kanadaja. "Ministri i Kulturës, në bazë të kompetencave të veta, këto ditë ka emëruar Komisionin Artistik, përgjegjës

për shqyrtimin dhe seleksionimin e projekteve konkurruese. Komisioni në përbërje: znj. Shqipe Kamberi - kryesuese, si dhe znj. Zana Ramadani dhe Arlinda Hajrullahu - anëtare, pas shqyrtimit të projekteve konkurruese dhe në përputhshmëri me politikën kulturore e programore të GMK-së për vitin 2020, në takimin e mbajtur më 22 janar 2020, vendosi për projektet dhe artistët/et që do të ekspozojnë këtë vit në Galerinë e Ministrisë

së Kulturës: Faik Krasniqi; Michael Stoeger, Florent Pista, Idlir Koka, Argenita Fetahu, Pranvera Kicaj, Yll Xhaferi dhe Engji Jaha", është thënë në njoftimin e Galerisë së Ministrisë së Kulturës (GMK). Gjithashtu, në bazë të kompetencave ligjore, koordinatoresha e GMK-së, Dhurata Ramosaj, ka të drejtë që, përveç këtyre tetë projekteve të përzgjedhura nga Komisioni, të ftojë për ekspozitë edhe dy artistë të dalluar vendës apo të jashtëm.



E rrallë

## Zbulohet unaza e arit 18 karat nga viti 1834

Një zbulues amator i metaleve që zbuloi një unazë ari nga viti 1834 planifikon ta ribashkojë atë me pasardhësit e pronarit. Unaza 18 karatësh mban emrin Elizabeth Honywood dhe datën e saj të vdekjes më datën 29 shtator 1834. Besohet se unaza është bërë nga burri i saj, Thomas Honywood, i cili bleu unazën pas vdekjes së gruas së tij të dashur. Unaza emocionuese u gjet nga Geoff Smith, 51 vjeç, në plazhin Lancing. Ai



iu drejtua komunitetit lokal përmes "Facebook"-ut për ndihmë në identifikimin e pronarëve originalë.

FOTO E DITES



Fëmijët e një shkolle në Afganistan mbajnë mësim në ambient të hapur. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Roboti ngre objektet e brishta pa prekje

Shkencëtari Marcel Schuck është duke punuar në zhvillimin e një kontrolli robotik që mund të ngritë objekte të brishta dhe të lehta pa prekje. Teknologjia për të cilën është duke punuar ky studiues nga Instituti Shkencor i Cirihiut bazohet në valët e zërit. Shpikja e tij



është një dorë roboti që është si një top i përgjysmuar në vend të grushtit.

## BARSOLETA E DITËS



Burri i një gruas kishte dalë në treg të blinte patate, por pas tri orësh vonësë ai nuk ishte kthyer në shtëpi dhe as nuk i përgjigjej në telefon. Dikur, gruaja e shqetësuar për të, e thërret policinë:  
- Burri ka dalë të blejë patate, por s'është kthyer që tri orë. Çfarë të bëj unë?  
- Për besë, zonjë, s'po dimë çfarë të të udhëzojmë. Po pse nuk po zieni fasule në vend të patateve?! - ia këthen polici.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



#### Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.  
**Regjia:** Jake Kasdan



#### Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min  
**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj.  
**Regjia:** J.J. Abrams



#### Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: Kino ABC.

 <p><b>DASHI</b> Do të keni pakë-naqësi në shikim. Kujdes, mos bëni asnjë gabim në biznes, veçanërisht me bashkëpunëtorët dhe partnerët e biznesit.</p>	 <p><b>DEMI</b> Do të jetë një ditë e mirë. Ju do të jeni në gjendje t'i shfrytëzoni horizontet më të gjera që do t'ju prezantojnë me inkurajimin e Hënës.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Paratë nuk bien shi nga qielli, por nga përpjekja e konsiderueshme në punë. Ju jeni shumë aktiv dhe i aftë për të marrë vendime.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Jeni të mbushur plot me dashuri dhe ëndrra romantike, por partneri juaj vazhdon t'ju zhgënjëjë.</p>	 <p><b>LUANI</b> Disa njohuri sterile dhe detyra të përsëritura krijojnë pakë-naqësi: përpiquni të bëni ndryshime!</p>	 <p><b>VI RGJËRESHA</b> Zemra është shumë e privilegjuar, e hedhur në trazira nga risitë e papritura. Nëse jeni çift, do të kaloni një mbrëmje të paharrueshme me shumë emocion dhe erotizëm.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Një kritikë, ndoshta e pamerituar, do t'ju drejtohet juve. Partneri sentimental do të ishte më i ëmbël dhe më i kuptueshëm nëse ju filloni ta tregoni veten më të disponueshëm.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Perspektivat profesionale duken të mira për të gjithë falë pozicionit të shkëlqyeshëm të Hënës. Nëse keni një biznes të vetëpunësuar, ju jeni në rrugën e duhur për ta mbyllur.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Në këtë periudhë ju keni nevojë të kujdeseni për veten dhe nevojat tuaja: të shikoni brenda vetes, të reflektoni për veten dhe zgjedhjet tuaja të jetës.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Intuita, ndjeshmëria dhe perspektivitë janë në krye. Faza pozitive edhe në fushën sentimentale, për të zbuluar dhe rizbuluar sa gjëra të përbashkëta keni me partnerin tuaj.</p>	 <p><b>UJORI</b> Do t'ju ofrohet të bashkoheni me një iniciativë humanitare; ju do të bëni çmos për ta dhënë ndihmën tuaj, duke mbledhur kontakte, mbështetje dhe mjete. Do të ndiheni pak i lodhur.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Fati ju buzëqesh dhe ju e ndihmoni atë me entuziazmin e momentit dhe projekteve të zgjuara!</p>

## Rikthehet 'Mean Girls,' por me një ndryshim madhor



**F**ilmi ikonik i vitit 2004 do të rikthehet sërish në ekran, por me një tjetër vizion. Në vitin 2018 filmi u përshtat në një shfaqje teatrale për Broadway dhe ajo shfaqje tani do të kthehet në një film. Domethënë, nga film në shfaqje komedi muzikore, në film

komedi muzikore. Ka kuptim? Tina Fey, e cila ka punuar edhe skenarin e filmit, edhe të shfaqjes, do të kujdeset për skenarin e rikthimit të 'Mean Girls' në ekran. "Kam shpenzuar 16 vjet me këto personazhe", ka thënë ajo në një deklaratë për media.

## A është kjo arsyeja e ndarjes së Rihannës nga Jameel?



**R**ihanna dhe Hassan Jameel u ndanë pas tre vjetësh bashkë dhe lajmi u bë i ditur para një jave. Me sa duket, këngëtarja 31-vjeçare dhe afaristi saudit nuk ishin përshtatje e mirë bazuar në jetët e tyre të ndryshme. "Jetët e tyre ishin

shumë të ndryshme dhe ishte e vështirë të mirëmbahet lidhja e dashurisë", ka deklaruar një burim. Fansat ishin "tronditur" kur ky lajm mori dhenë, veçanërisht pasi ajo në kohë të fundit lë të kuptohet se ishin gati për martesë dhe për fëmijë.



## 64 vjeçja në pasarellet e modës në Paris

Aktorja e njohur italiane Ornella Muti ka dalë në pasarellet e modës Haute Couture për mikeshën e saj stiliste Ulyana Sergeenko. Aktorja që ishte simbol i sensualitetit gjatë viteve '80 mori vëmendjen e të gjitha mediave me ecjen e saj në

pasarelë. 64-vjeçja tregoi edhe një herë që për të mosha është vetëm një numër. Shpesh thuhet se nuk është asnjëherë vonë në jetë ta ndryshosh vizionin e dikujt për veten. E Ornella e bëri këtë. Ajo eci në pasarellet e modës në moshën 64-vjeçare në Paris.

## Hilary Duff thotë se vellon do ta ruajë për vajzën

**A**ktorja e njohur Hilary Duff një muaj më parë është martuar me Matthew Koma. Ajo për "People" ka thënë se fustanin e ëndrrave ia ka dizajnuar

Jenny Packham. Duff tregoi se ka pasur shumë problem me fustanin pasi i ishte bërë pis shumë shpejt. Ajo, gjithashtu, deklaroi se vellon do t'ia japë vajzës së vet.





		<b>Autor:</b> <b>GAZMEND MORINA - BENI</b>	PJESË E DHOMËS (sh.shq.)	SËMUNDJE E FËMIJËVE, QË SHFAQET ME SHTRËMBËRIMIN E ESHTRAVE	E BËRA GATI	NDËRTIM ME TË CILIN E RRETHOJMË OBORRIN (shq.)	NEGRI, ZEZAK	TEDI ALVES	<b>EPOKA E RE</b>	E PALËVIZSHME	VITI I RI KINEZ	TOKA E BUKËS	KLUB FUTBOLLI NË ITALI
	MË VJEN GJUMË DUKE NDEJUR, FLE PAK DUKE NDEJUR								SUPER MODELJA KANADEZE JESSICA				
	EMËR I VJETËR PËR DUBROVNIKUN								AKTORJA AM. .... HATCHER MBËTURINË E NJË KAFSHE PARAHISTORIKE				
	FLUTURUESI I PARË SIPAS MITOLOGJISË							VDEKJEPRURËS ZET, OKSIGJEN					
	HISTORIANI ROMAK LUKRECI (shq.)						ALLAHU, PERËNDIA SHKRONJA TË NJËJTA					ZANORE KAPITULL I FUNDIT I NJË VEPRE LETRARE	
	BABAI					MOTOÇKLISTI I NJOHUR VALENTINO E PËRZIER					EMPOLI, NAPOLI KËNGËTARI .... VLADI		
	KALORËS MESJETAR							I ZË ME DORË SILLEM LART E POSHTË					ZVOGËLIMI DERI NË PIKËN MË TË ULËT
	THIRRJE E MYEZINIT						GJELBËRIM ZANORE						
<b>EPOKA E RE</b>	FUTBOLLISTI YNË I TALENTUAR NË FOTO (LLAMKOS KOSOVA)	PJESËTARËT E NJË FISË ILIR	GJUMI I THELLË (med.)	ISH SEKRETARI I OKB-së KOFI ....	RITUAL	SHKRONJA XXVIII & VIII ADRIAN KRASNIQI	AJËR (huaj) PROVIM		DËSHIROJ	INDIAN LAW INSTITUTE REGJISORI MINAROLLI			
	MEKANIZËM QË SHËRBEN PËR TË LEHTËSUAR NGRITJEN E PESHAVE TË RËNDA					MISSISSIPPI TUNDER KINGS ENËT E POSACMË KU MBAHËT HIRI I TË VDEKURIT		TËRËSI E GJALLESAVE NË TOKË VARGJET E PËRPUTHURA					
	SHALQI (shq.)					KUNDREJT ANASE, RRËNJËSE "N" pas dy "A"					GABRIEL IGLESIAS KYÇ		
	LLOJ DEVE E VENDEVE TË AMERIKËS JUGORE (sh.shq.)					MUNDËSIA SULMIMET		PËREMËR VETOR QESËNDISËS				BASHKËT. TER, KA	
	BASKETBOLLISTI TURK OMER ....				DEGË E MJEKËSISË KITARISTI I FAMSHËM KLEPTON				FUTBOLLISTI SHQIPTAR .... LILA REGJISORJA SHQIPTARE .... ELEZI				
	SHKRONJA TË NJËJTA		GJITAR I DËTEVE POLARE	GAZ I PANGJYRË DHE PA ERË MODELJA ÇUNMULAJ			LLOJ HELMI LUFTE NJË PLANET				EDA ZARI DY ZANORE		
	KUMTIM I GJERË ME SHKRIM, QË MBAHËT PARA NJË MBLËDHJEJE					KUJDESTAR (jurid.) RRIPI I LLAMBËS			PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE FËMIJË I VOGËL				
	BËRTHAMOR					FELLOWSHIP OF RECONCILIAT. BARAZIM NË SHAH		MODELJA AMERIKANE .... TAYLOR HUMORISTI BESIM ....				MOLDE DIREK I ÇATISË	
	BASHKËT.	BIMË QË BËN KOKRRA TË THARA E QË HAHEN TË PJEKURA SMIRA, RESA					CA SHTËT NË EVROPË (pashq.)				TITAN JETËSHK-RIMET		
	SIMBOL I FESË MYSLIMANE, BESIM; BESË				QË ËSHTË PREJ METALI, I METALTË KUMBARË				DAFINË BASHKËT.				FUQI, FORCË (bised.)
	KARBON, AMPËR		PAGJAKËSI POETI .... VINCA				EDUARD NORTON U ARRATISË NGA BURGU		FLEGËR ZOG ROSE, BIBË ROSE (shq.)				
	LLOJ PAPANALLI			QË SHEH VETËM DOBINË E ÇASTIT OLIVER (shk.)					MARC ANTHONY "TETOVA"			ZANORE GRIMCOVA (bised.)	
<b>EPOKA E RE</b>	NIS TË ZBARDHË DITA ALUMIN					ISH FUTBOLLISTI I NJOHUR BRAZILIAN PRODUKT I ZJARRIT		SFOND SHKRONJASH ISMET HASANI					
	SHTËPI PLEQSH				HAITI, INDIANA BASHKËT.		E BASHKUAR ISLANDA				SOLISTJA QAZIMI ZANORE		
	KUFIZIMI						I KAPËRDUJ		SHTËT (FR.)				



# Salih Uglla, lahutari legjendar i Peshterit

Eposi shqiptar i kreshnikeve, siç del edhe nga kuptimi që ka marre fjala kreshnik, është një epos heroik. Fryma heroike e përshkon atë fund e krye; me brumë heroik është ngjizur çdo strukturë e mikrostrukturë e tij. Veçse këtu heroizmi nuk del si diçka e jashtme, si vetëmburrje a si mjet për të tërhequr simpatinë e dikujt. Ai është krejt spontan, i brendshëm, buron nga domosdoshmëria e rezistencës dhe e përballimit të rreziqeve e të vështirësive.

Eposi e paraqet heroizmin si mënyre mendimi, sjelljeje a veprimi, që ve në qendër të sistemit të të gjithë vlerave trimërinë, vetëmohimin, që i quan atotribute të pandara te një mjedisi shoqëror të përcaktuar etnikisht, të një mënyre të veçante organizimi shoqëror. Ai e trajton heroizmin si një tradite të lashte, si një kult të vërtete, si një model etnokulturë të kristalizuar, madje të sakralizuar, gjatë shekujve.

Peshteri prej kohësh ka qenë çerdhe dhe thesar i lahutarëve. Deri në fund të shekullit XVII ky rajon është karakterizuar me homogenitet etnik, të cilin më vonë do të ndërpresin vendosjet gjithnjë e më të shpeshta, trazirat dhe migrimet masive. Migrimet janë intensifikuar veçanërisht pas formimit të Sanxhakut të Pazarit të Ri (1877), gjegjësisht pas shpërbërjes së tij nga Vilajeti i Bosnjës dhe bashkimit me Kosovën. Kështu, rezultojnë në Peshter përzjerja e kulturës lokale dhe shpirtërore me atë të të ardhurve nga Hercegovina, bregdeti malazez dhe nga muhaxherët tjerë boshnjak që arritën nga vendet e okupuara nga Serbia në vitin 1878.

Kjo lëvizje e popullsisë ka shënuar ndikim të madh në fushën e kulturës gojore epike që gradualisht depërtoi në shtëpitë e popullsisë lokale shqiptaromyslimane. Prandaj, është i justifikueshëm vlerësimi i Husein Bashiqit: "Nuk ka pothuajse trevë në vendin tonë në të cilin në një hapësirë kaq të vogël të ketë ndodhur depërtim më intensiv i shprehjes shpirtërore të shumë popujve" (boshnjakëve, malazezëve, serbëve dhe shqiptarëve).

Alija Xhogoviq shkruan: "Në Peshter, të gjithë banorët i punojnë me mjeshtri dhe dashuri



lahutat me të cilat ekzekutojnë shkëlqyeshëm këngët e reja dhe të vjetra. Në kontekst të këtij referimi potencoj se në shkurt të viti 2005 në Velepole të Tutinit kam prezantuar në një këndim epik boshnjak, në një shfaqje lokale në të cilën, me programin e tyre morën pjesë lahutarët popullor dhe këngëtarët e këngëve heroike, duke ekzekutuar me kavall dhe duke kënduar këngë 'Dy nga dy', edhe atë vetëm meshkujt - sipas melosit të vjetër peshteras (shqiptar v - I. A)".

Në fshatra, posaçërisht në dimër, janë organizuar ndeja. Njerëzit janë tubuar nëpër oda në shtëpi të familjeve imune ku vinin lahutarët dhe ku këndohej edhe deri në mëngjes. Më së shumti janë tubuar në fshatrat Shipovicë, Godijevë (në shtëpitë e Sijariqëve), në Koritë (në shtëpitë e Mekiqëve, Mehajve dhe Alihoxhajve), në Cërhal, Dashqarijekë, Vrbicë, në disa fshatra të Rozhajës, Tutinit dhe Senicës.

Bazë e tematikës epike e këtyre këngëve kanë qenë këngët për luftërat e këngëtarëve të Plavës e Gucisë për ruajtjen e integritetit gjeografik dhe kulturor, lirinë dhe të drejtat për pavarësi. Pra, në mesin e dytë të shek. XIX dhe gjatë shek. XX, posaçërisht në

lidhje me ngjarjet nga viti 1912 dhe deri në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore.

"Oj qikë me fistan të bardhë! / Inshaallah peshterasit vijnë me të marrë!"

Peshterasit në shaka, por shpesh edhe me përbuzje, për disa lahutarë të cilët kanë qenë në gjendje jo të lakmueshme ekonomike, kanë përdorë një thënie të njohur: "Takum pasha, hall magjupi" (I veshur si Pashë, ndërsa gjendja ekonomike e familjes shumë e keqe).

Salih Uglla (Ugljanin) (1849-1945) ose Salih Peshteri është nga fshati Ugëll (Ugao) të Peshterit. Siç është deklaruar vëllazëria e tij, ai është me prejardhje nga fisi Kelmend i besimit katolik. Nga ana e nënës ai rrjedhë nga Gucia. Me lahutë dhe këndim ka filluar të merret nga moshë 15 vjeçare kurse mësimet i ka nxënë nga Husë Qorri Husoviq nga Kollashini, nga peshterasi Hamzë Alibasha nga Suhodoli dhe nga Huzëir Baliq - Huzbalia nga Dobri Dubi, gjithashtu lahutar i këngëve kreshnike.

Uglla ka filluar herët të merret me shitblerjen e kafshëve në Selanik dhe Shkodër. Në bazë të incizimeve të Milman Parry (The Milman Parry Collection of

Oral Literature), mësojmë se rreth vitit 1908 ka shkuar të jetoj në Pazarin e Ri. Aty u bë pronar i një Hani dhe e mbajti në posedim deri në fillim të Luftërave Ballkanike 1912/13. Sipas Prof. Dr Zymer Neziri Uglla ka qenë edhe pjesëmarrës në luftën për mbrojtjen e Plavës dhe Gucisë.

Në fshatin Uglla, sipas tij, kanë qenë 70 shtëpi të fiseve ilire katolike-myslimane (Uglla, Hukiq, Bibiq, Martinoviq, Zahirovq, Zukoviq, Plakiq, Kurbashevq, Arslanoviq, Seferoviq etj.). Me lahutë ka kënduar Ramë Zuka (Ramo Zukov) i cili është mësuar gjatë qëndrimit të gjatë në Bosnjë. Vlerësimet e disa hulumtuesve, kanë qenë krejtësisht tendencioze dhe jo të sakta që kishin për qëllim ta klasifikonin Uglën si lahutar të nivelit mesatar (M. Murko, Albert B. Lord, Gesemann, A. Schmauss dhe Rajko Medenica). Këtë e vërteton edhe profesor. Zymer Neziri, i cili thotë: "Salih Uglla nuk qëndron nën hijen e Megjedoviqit, është shumë i madh, madhështor, këtë e kanë bërë shkencëtarët serb me qëllim të ngritjes së Avdo Mexhedoviqit, të cilin me çdo kusht janë munduar ta paraqesin si sllavo-boshnjak, me qëllim që të mohojnë eposin

shqiptarë në Sanxhak".

Neziri përshkruan edhe bisedën të cilën e ka zhvilluar Profesori nga Harvardi, me S. Uglën, i cili dëshmon para tij përkatësinë e tij etnike shqiptare, duke ia përshkruar shkuarjen e tij të parë te familja e gruas së tij të dytë e cila nuk ishte shqiptare. Para këtij rrëfimi, i cili është i incizuar dhe ruhet në Harvard, profesori amerikan kupton se ka të bëjë me një popull i cili nuk është sllav, e që vetëm rastësia i ka bërë të ngjashëm dhe jetojnë së bashku në këto treva. Pas kësaj ngjarje profesori e porositi asistentin e tij që të vazhdojnë studimet për shqiptarët.

Salih Ugljanini tregon se shumë lahutar kanë ushtruar dhe kanë arritur të bëhen të mirë falë "shortimit" dhe duke dëgjuar të famshmin dhe të verbrin në njërin sy, Qorr Hysën nga Kollashini, i cili ishte mysafir i përhershëm në fshatrat e Peshterit. Në vitin 1953, prof. Beliq nga Beogradi ka bërë marrëveshje me Kembrixhin për botim të këngëve. Lordi, siç ka shkruar parathënien e librit, e ka dërguar dorëshkrimin në Beograd por Beliq ka hequr 10 rreshta, pjesën ku bëhet fjalë për lahutarët dygjuhësor.

/Telegrafi/

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Rexha: Me rikthimin tim Drita rikthen titullin

Kastriot Rexha në dy vjetët e fundit arriti ta fitojë titullin e kampionit me Dritën dhe Feronikelin dhe synim ka që edhe në këtë edicion të shpallet sërish kampion. "Pas ndërprerjes së kontratës me Feronikelin, ofertat nuk munguan, por ajo e Dritës ishte shumë serioze dhe fakti se kam luajtur në këtë klub edhe më herët dhe kemi fituar edhe titullin pas shumë vitesh ndikuan që ta pranoj këtë ofertë. Kam kaluar mirë në të kaluarën dhe kemi arritur suksese së bashku, prandaj rikthimi im aty është që sërish të shpallemi kampionë", ka thënë Rexha



**EPOKA E SHTUNË** Veton ZYMBERI

Prishtinë, 24 janar - Lojtari më i mirë në Superligën e Kosovës për vitin 2019, Kastriot Rexha, ndërpreu bashkëpunimin me Feronikelin, pas insistimit të klubit nga Drenasi për ta ndërprerë kontratën. Ofertat për sulmuesin më të mirë në vend nuk munguan nga shumë klube që pretendojnë titullin e kampionit, por Rexha vendosi ta pranojë ofertën e Dritës.

Sulmuesi prishtinas të premtën për "Epokën e re" ka treguar arsyet pse vendosi që të rikthehet në Gjilan. "Pas ndërprerjes së kontratës me Feronikelin, ofertat nuk munguan, por ajo e Dritës ishte shumë serioze dhe fakti se kam luajtur në këtë klub edhe më herët dhe kemi fituar edhe titullin pas shumë vitesh ndikuan që ta pranoj këtë ofertë. Kam kaluar mirë në të kaluarën dhe kemi arritur suksese së bashku, prandaj rikthimi im është që sërish të shpallemi kampionë", ka

thënë Rexha. Sulmuesi që mori edhe çmimin e golashënuesit më të mirë në Superligë dhe ishte i përfshirë në formacionin më të mirë të vitit e ka ripërsëritur edhe një herë se vendimi i drejtuesve të "Niklit" ishte befasues, pasi shumica e lojtarëve të larguar ishin pjesë e sukseseve. "Fillimisht më ka befasuar vendimi i klubit sepse shumica nga lojtarët ishin bartës të sukseseve. Megjithatë, e falënderoj Feronikelin për bashkëpunimin dhe korrektësinë e treguar, por jam shumë krenarë me atë që kam dhënë për këtë klub", ka shtuar ai.

Përfaqësuesja e Kosovës në këtë muaj e zhvilloi një ndeshje miqësore me Suedinë, por Rexha nuk bënte pjesë në formacion, ani pse trajneri Bernard Challandes kishte ftuar 13 lojtarë nga Superliga. Lidhur me këtë mungesë, Rexha ka deklaruar: "Kam fituar të gjithë titujt e mundshëm në Kosovë dhe kam përvojë edhe në futbollin e Shqipërisë dhe besoj se e kam merituar një ftesë të tillë, por gjithmonë edhe në nivel klubesh i kam respektuar

vendimet e trajnerëve, prandaj e respektoj edhe vendimin e Challandesit".

Sulmuesi që ka bërë karrierë edhe në klubet si Prishtina, Besa e Pejës, Trepça '89, Hysi dhe 2 Korriku nuk ka dashur të flasë shumë rreth skuadrave që janë favorite kryesore në garën për titull. Ai ka parashikuar se lufta do të jetë shumë e fortë për këtë trofe dhe se në fund triumfuese do të dalë skuadra e Dritës.

Skuadra e Dritës të premtën paradite ka udhëtuar drejt Turqisë për ta vazhduar fazën përgatitore për sezonin pranveror. "Aska Lara Resort do të jetë vendi ku do të akomodohet ekipi për njëmbëdhjetë ditë dhe gjatë kësaj kohe janë paraparë edhe tri takime kontrolluese", thuhet në njoftimin e klubit gjilanas.

Drita është e përqendruar vetëm në garën për titull, pasi tashmë është eliminuar nga gara e Kupës. Kjo skuadër sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e tretë në tabelë me 31 pikë, tri pikë më pak se skuadra kryesuese e elitës, Ballkani.

## SHKURT

### Laura Fazliu eliminohet në rundin e dytë

Laura Fazliu ka pësuar disfatë në rundin e dytë të kategorisë deri në 63 kilogramë në Grand Prix që po zhvillohet në Tel Aviv të Izraelit. Xhudistja 19-vjeçare nga Kosova e ka kaluar rundin e parë pa luftë falë fatit në short. Megjithatë, Laura Fazliu nuk ka arritur të kalojë më shumë se rundi i dytë dhe kështu e ka mbyllur rrugëtimin në këtë Grand Prix. Xhudistja nga Kosova u mposht me 'ippon' nga rusja Ekaterina Valkova, e cila e mposhti me përvojë pasi është 28-vjeçare. Të enjten Erza Muminoviq dhe Flaka Loxha u eliminuan, ndërsa Nora Gjakova arriti ta rrëmbejë medaljen e bronzit.

### Vllaznia prezanton gjashtë transferimet

Vllaznia e Pozheranit ka zyrtarizuar gjashtë futbollistë të transferuar së fundmi. Katër prej tyre vijnë nga Vushtrria, një nga Dardana dhe një tjetër nga Istogu. Kujtim Pantina, Armend Kastrati, Petrit Tahiri, Ismet Caka, Rinor Karaxha dhe Leutrim Teplani janë ardhjet e fundit në klubin pozheranas. Futbollistët janë prezantuar nga drejtori sportiv i kësaj skuadre, Agron Pira, teksa janë zyrtarizuar edhe në faqen zyrtare të klubit. Pozheranasit kanë paralajmëruar edhe përforcime të tjera, kurse trajneri i kësaj skuadre është emëruar Erdin Hashani.

### Agjenti i Januzajt: Jemi në bisedime me Romën

Agjenti i Adnan Januzajt e ka pranuar se është në bisedime me përfaqësues të Romës për ta diskutuar mundësinë e një transferimi gjatë këtij muaji nga Real Sociedad. Ai shtoi se shpreson që marrëveshja të arrihet brenda ditëve të ardhshme. Futbollisti vlerësohet 12 deri në 15 milionë euro dhe të dyja palët duhet të vendosin sot se çfarë përqindje e kësaj shume do të paguhet për huazimin dhe pastaj çfarë përqindje do të lihet për opsionin për blerje. "Ne jemi në kontakt me Romën. Jemi duke i vlerësuar kushtet e ofertës, që mund të jetë huazim me opsion për blerje. Tani shpresojmë ta përfundojmë gjithçka brenda pak ditëve", ka thënë Dir de Vriese.

### Reali dhe Barça mësojnë kundërshtarët në Kupë

Të premtën është hedhur shorti për rundin e 1/8 të finales së Kupës së Botës. Real Madridi i ra shorti të udhëtonte për ndeshjen kundër Real Zaragoza, ndërsa Barcelona do të përballet me Leganes në "Camp Nou". Barcelona dhe Real Madridi kaluan në këtë fazë pas fitoreve si mysafirë kundër Ibizas dhe Salamancas. Ndërsa Atletico Madridi u eliminua nga Cultural Leonesa. Në fazën e 1/8 të finales, Cultural do të përballet me kampionen në fuqi të këtij turneu, Valencian. Çiftet: CD Badajoz-Granada, Cultural Leonesa-Valencia, Tenerife-Athletic Club, Real Zaragoza-Real Madrid, Mirandes-Sevilla, Rayo Vallecano-Villarreal, Barcelona-Leganes, Real Sociedad-Osasuna.

## Liria rikthen Karahodën, Gashin dhe Dinën

PRIZREN, 24 JANAR - Liria e Prizrenit po vijon fazën përgatitore nën drejtimin e trajnerit Skënder Shengyli. Gjatë këtyre ditëve po vërehet punë dhe përkushtim i të gjithëve, që nga shtabi teknik, futbollistët dhe

vetë drejtuesit e KF Liria. "Ndonëse kemi nisur me shumë vështirësi tashmë të njohura, ne bashkërisht po bëjmë punën tonë që të jemi sa më të përgatitur për stinorin pranveror", ka thënë kryetari i klubit, Qemal

Krasniqi. Kjo skuadër ka arritur që t'i rikthejë ish-futbollistët e saj, Fatih Karahoda, Qëndrim Gashi dhe Behar Dina. "Kemi arritur marrëveshje pas takimit dhe bisedave që kishim me drejtuesit e ri të Lirisë. Shpresoj

dhe premtot që me angazhimin e të gjithëve Lirinë ta kthejmë në Superligë", ka thënë Karahoda, i cili, së bashku me Qëndrim Gashin dhe Behar Dinën, do të paraqiten të shtunën në stërvitje.



## Përballje interesante në Superligë

PRISHTINË, 24 JANAR - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 22-të e Superligës së Kosovës në basketboll. Takimi i parë do të jetë ndërmjet Lipjanit dhe Ponte Prizrenit. Lipjanasit kanë vetëm një fitore në këtë edicion, kurse prizrenasit 11 fitore dhe tetë humbje, duke u renditur në vendin e katërt. Ndeshje interesante pritet të zhvillohet në mes të Trepçës dhe Rahovecit në "Minatori". Mitrovicasit kanë katër fitore dhe 14 humbje, duke u renditur në vendin e tetë, kurse Vreshtarët kanë 14 fitore dhe pesë humbje, duke grumbulluar 33 pikë, aq sa ka edhe Sigal Prishtina. Si Trepça, ashtu edhe Rahoveci, kanë bërë përforsime për stinorin vjeshtor dhe ballafaqimi i së shtunës pritet të jetë mjaft interesant. Përballja më interesante e kësaj xhiroje do të zhvillohet ndërmjet Bashkimit dhe GoldenEagle Yllit. Prizrenasit ndodhen në vendin e katërt me 30 pikë apo 12 fitore dhe gjashtë humbje, kurse



therandasit janë në vendin e tretë me 32 pikë ose 13 fitore dhe gjashtë humbje. Sfidat e fundit do të zhvillohet ndërmjet Feronikelit dhe Pejës. Skuadra nga Drenasi renditet në vendin e shtatë me pesë fitore dhe 14 humbje, ndërsa pejanët ndodhen në vendin e gjashtë me 10 fitore e tetë humbje. Sigal Prishtina pushon në këtë xhiro.

### SUPERLIGA - JAVA 22

Të shtunën takohen:  
17:00 Lipjani - Ponte Prizreni  
19:00 Trepça - Rahoveci

Të dielën takohen:  
17:00 Bashkimi - GoldenEagle Ylli  
19:00 Feronikeli - Peja

## LeBron shkëlqen në fitoren e Lakersave ndaj Brooklynit

LOS ANGELES, 24 JANAR - Vetëm tri përballje në NBA, por të mjaftueshme për ta ofruar spektaklin e zakonshëm në kampionatin më të bukur të basketbollit në glob. Los Angeles Lakersi me LeBron Jamesin bëri dallimin mbi parket dhe iu imponuan me rezultat 113-128 Brooklyn Nets të Kyrie Irvingut. "Mbreti" i NBA-së e mbylli takimin me "triple double", 27 pikë, 12 "rebounde" dhe 10 asistime, ndërsa Anthony Davis e Dwight Howard realizuan "double double" secili, i pari 16 pikë e 11 "rebounde" dhe i dyti 14 pikë e 12 "rebounde". Irvingu ishte më i miri në radhët e Netsit me 20 pikë. Fituan edhe Washington Wizardsi, 112-124, në shtëpinë e Cleveland Cavaliersit, në një sfidë mes dy ekipeve që nuk kanë më pretendime për këtë sezon, pasi renditen larg zonës "play-off". Luan një ndeshje të madhe Bradley Beal, autor i 36 pikëve, duke fituar edhe duelin brenda sfidës me Colin Sexton të Cavs, që regjistroi 29 pikë. Në ndeshjen e



fundit të mbrëmjes, Dallas Mavericksi, i shtyrë nga 27 pikë dhe 9 asistime të Luka Donçiqit, kaloi Portland Trail Blazersi në Oregon me rezultat 133-125. Nuk vlejti për asgjë paraqitja jashtë normales e Damian Lillard,

autor i 47 pikëve, 6 "reboundeve" e 8 asistimeve. Teksanët, edhe pse jemi në mes të sezonit, tashmë e kanë të prenotuar një vend në fazën "play-off", ndërsa Blazersi duhet të luftojë ende shumë për ta arritur vendin e tetë në Perëndim.

### REZULTATET

Los Angeles Lakers - Brooklyn Nets	128-113
Washington Wizards - Cleveland Cavaliers	124-112
Dallas Mavericks - Portland Trail Blazers	133-125

### SHKURT

#### Reali në verë e transferon Mbappen

Kylian Mbappe mund të transferohet në Real Madrid. Ylli i madh i Paris Saint-Germainit në ditët e fundit ka konfirmuar vendosmërinë e tij për ekipin francez. Mirëpo, ai ka refuzuar të konfirmojë të ardhmen e tij në klub përtej këtij sezoni. "AS" shkruan se Real Madridi ka shtuar besimin për transferimin e tij gjatë afatit kalimtar të verës. Mbappe është një prej futbollistëve të rinj më të mirë në botë dhe objektiv i madh i klubit nga "Santiago Bernabeu".

#### Erikseni kërkohet edhe nga Barça

Të gjitha mediat në Itali bëjnë thaujse të sigurt kalimin e Christian Eriksen tek Interi, por "Sky Sports.com" raporton se tashmë në mes është futur Barcelona. Lojtari është ende pjesë e Tottenhamit dhe kontrata e tij skadon në fund të këtij sezoni. Erikseni kërkon largimin, gjë që e do edhe skuadra angleze, për të mos e humbur lojtarin pa futur asnjë qindarkë në arkë. Barcelona tashmë është futur në mes të Interit dhe Tottenhamit dhe kërkon që ta joshë klubin anglez me një ofertë më të mirë se ajo e Interit.

#### Zaza, afër rikthimit në La Liga

Sulmuesi Simone Zaza mund të provojë sërish një aventurë në La Liga. Sulmuesi i Torinos i ka përmbushur pritshmëritë në këtë sezon ndaj dhe drejtuesit e klubit "Granata" mendojnë që ta shesin gjatë merkatos së janarit. Përveç klubeve në Serinë A, si Sassuolo apo Sampdoria, për ish-sulmuesin e Juventusit ka shprehur interesim edhe Villarreali. Spanjollët kanë përgatitur një ofertë për të e, nëse transferimi realizohet, për Zazën do të bëhej fjalë për një rikthim në La Liga, pasi në sezonin 2017-2018 ai luajti me fanellën e Valencias.

#### Eliminohen Serena Williams dhe Caroline Wozniacki

Ndeshjet e raundit të tretë të grand slamit të Australian Openit, turne që po zhvillohet në Melburn, kanë nisur me surpriza. Tenistja kineze Qiang Wang mposhti 2-1 ikonën amerikane Serena Williams (6-4, 6-7, 7-5). Një ndeshje me rivalitet në të tri setet, por Williamsi nuk ishte në ditën e saj më të mirë, duke zhgënjyer ndaj një teniste jo shumë të njohur. Eliminohet edhe një tjetër ish-numër 1 në botë për femra, danezja Caroline Wozniacki. Ajo u mund 2-1 (7-5, 3-6, 7-5) nga Ons Jabeur e Tunizisë, një rezultat surprizë. Kjo ishte ndeshja e fundit e Wozniackit në karrierën e saj, pasi ka vendosur të tërhiqet nga sporti, edhe pse vetëm 29 vjeçe. Nuk zhgënjën tenistja çeke Petra Kvitova, numri 7 në botë, që mundi 2-0 (6-1, 6-1) Ekaterina Alexandrova dhe avancon më tej. Në raundin e katërt avancon tenistja australiane Ashleigh Barty, numri 1 në botë. Ajo mundi 2-0 (6-3, 6-2) kaçaken Elena Rybakina.

#### Kloppi: Më vjen për të vjellë kur dëgjoj se ne mund të humbim gjashtë ndeshje

Liverpooli siguroi fitoren e 22-të sezonale, nga 23 takime të zhvilluara gjithsej në Premier Ligë, duke ruajtur distancën prej 16 pikësh me Manchester Cityn e vendit të dytë, pa harruar faktin që ka një ndeshje më shumë për të zhvilluar. "The Reds" mund të humbë gjashtë ndeshje deri në fund e sërish do të shpallej kampion i Anglisë, por trajneri Jurgen Klopp ka një përgjigje të fortë për të gjithë ata që mendojnë se gjithçka është mbyllur. "Më vjen për të vjellë kur dëgjoj se ne mund t'i humbim gjashtë ndeshje. Titulli fitohet atëherë kur gara mbyllet, jo më parë", ka thënë Klopp. "Ne nuk ishim të përsosur, por reaguam në mënyrë të përsosur. Djemtë dinë të luftojnë në situata të vështira, kjo është ajo që ne bëjmë përsëri", ka thënë Klopp për ndeshjen ndaj Wolvesit. Lidhur me lëndimin e Manes, Kloppi ka deklaruar: "Ndjeu një shtrëngimin dhe do të duhet të presim derisa ta dimë masën e problemit".



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport  
Nacionalni Koordinator za Kulturu, Omladino i Sporti  
National Coordinator for Culture, Youth and Sport

Bazuar në nenin 12, paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe Vendimit Nr. 01/86 më datë 25.01.2019 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, bënë:

### Shpallje të Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit:	Zyra e Kryeministrit
Njësia Organizative:	Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport
Titulli i punës:	Nënkoordinator rajonal
Numri i referencës:	KNKRS/MSHV- 001,
Tarifa e shërbimit:	E negociuar
Raporton :	Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Gjashtë (6) muaj
Orari i punës:	I plotë
Numri i ekzekutuesve:	1 (një)
Vendi:	Prishtinë

#### Detvrat dhe përgjegjësitë e të angazhuarit për MSHV:

- Ndihmon në hartimin dhe zbatimin e projekteve dhe shërbimeve përkatëse në projektet e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport;
- Kryen detyrat e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
- Ofron informata për stafin brenda Zyrës së Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësisë të tyre;
- Udhëheqë dhe koordinon aktivitetet në terren të cilat organizohen në kuadër të projekteve të Zyrës së Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport;
- Bën koordinim të punës me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon sipas nevojës me autoritetet e jashtme;
- Kryen çdo detyrë tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;
- Harton raporte me shkrim për Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në baza ditore.

#### Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë universitare
- 3 vite përvojë pune
- Aftësi shumë të mira në të shkruar dhe komunikim të gjuhës shqipe. Njohja e gjuhës Angleze e obliguar, njohja e gjuhëve tjera e preferueshme.
- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
- Patentë shoferi i obligueshëm
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për fushat përkatëse;
- Shkathësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathësi hulumtues, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Ëord, Excel, Poëer Point, Access);

Emri i Institucionit:	Zyra e Kryeministrit
Njësia Organizative:	Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport
Titulli i punës:	Nënkoordinator rajonal nga komuniteti serb
Numri i referencës:	KNKRS/MSHV- 002,
Tarifa e shërbimit:	E negociuar
Raporton :	Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Gjashtë (6) muaj
Orari i punës:	I plotë
Numri i ekzekutuesve:	1 (një)
Vendi:	Prishtinë

#### Detvrat dhe përgjegjësitë e të angazhuarit për MSHV:

- Ndihmon në hartimin dhe zbatimin e projekteve dhe shërbimeve përkatëse në projektet e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport;
- Kryen detyrat e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
- Ofron informata për stafin brenda Zyrës së Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësisë të tyre;
- Udhëheqë dhe koordinon aktivitetet në terren të cilat organizohen në kuadër të projekteve të Zyrës së Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport;
- Bën koordinim të punës me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon sipas nevojës me autoritetet e jashtme;
- Kryen çdo detyrë tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;
- Harton raporte me shkrim për Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në baza ditore.

#### Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë universitare
- 3 vite përvojë pune
- Aftësi shumë të mira në të shkruar dhe komunikim të gjuhës shqipe. Njohja e gjuhës Angleze e obliguar, njohja e gjuhëve tjera e preferueshme.
- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
- Patentë shoferi i obligueshëm
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për fushat përkatëse;
- Shkathësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathësi hulumtues, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Ëord, Excel, Poëer Point, Access);

Emri i Institucionit:	Zyra e Kryeministrit
Njësia Organizative:	Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport
Titulli i punës:	Asistentë të nënkoordinatorëve rajonalë
Numri i referencës:	KNKRS/MSHV-014, 015,
Tarifa e shërbimit:	E negociuar
Raporton :	Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Gjashtë (6) muaj
Orari i punës:	I plotë
Numri i ekzekutuesve:	2 (dy)
Vendi:	Prishtinë

#### Detvrat dhe përgjegjësitë e të angazhuarit për MSHV:

- Asiston nënkoordinatorin rajonal ndihmon në hartimin dhe zbatimin e projekteve dhe shërbimeve përkatëse në projektet e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport;
- Kryen detyrat e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
- Asiston nënkoordinatorin rajonal në përpilimin e hulumtimeve, analizave, vlerësimeve të opsioneve dhe rekomandimeve për shqyrtim nga nivelet e larta rreth detyrave ose projekteve të specializuara të miratuara për Zyrën e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport;
- Ofron informata për stafin brenda Zyrës së Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësisë të tyre;
- Ndihmon në fushën e promovimit të Investimeve Strategjike sipas ekspertizës së kërkuar brenda institucionit;
- Asiston në udhëheqjen dhe koordinimin e aktiviteteve në terren të cilat organizohen në kuadër të projekteve të Zyrës së Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport;
- Bën koordinim të punës me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon sipas nevojës me autoritetet e jashtme;
- Kryen çdo detyrë tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;
- Harton raporte me shkrim për nënkoordinatorin rajonal në baza ditore.
- Harton raporte me shkrim për Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në bazë të kërkesave së tij.

#### Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë e shkollës së mesme;
- Aftësi shumë të mira në të shkruar dhe komunikim të gjuhës shqipe. Njohja e gjuhës angleze dhe serbe e preferueshme;
- Të ketë njohuri për sistemin e përgjithshëm të edukimit në Kosovë;
- Shkathësi në komunikim, planifikim të punës;
- Shkathësi hulumtues, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve;
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Ëord, Excel, Poëer Point, Access).

#### INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët e interesuar për angazhim, për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta,

duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në;
- Letër motivimin;
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës, referenca dhe çdo dokument tjetër i cili demonstroi dhe vërtetoi përmbushjen e kriterëve të fushës përkatëse);
- Certifikatë (dëshminë) që s'është nën hetime;
- Kopje të letërnjoftimit.

Dokumentacionet duhet të jenë në pliko (zarf) të mbyllur dhe të dorëzohen në Zyrën e Koordinatorit Nacional për Kulturë Rini dhe Sport/ Zyrën e Kryeministrit, sheshi Nëna Terezë, Ndërtesa e Qeverisë, kati VIII, zyra nr. 806 ose përmes postës, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh; aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Kompensimi është i negociueshëm.

Zyra e Koordinatorit Nacional për Kulturë Rini dhe Sport/ZKM, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit: **038 200 14 060**

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për listën e ngushtë.

**Afati i aplikimit është i hapur 7 ditë nga data e publikimit, nga data 25/01/2020 deri më datën 31/01/2020.**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport  
Nacionalni Koordinator za Kulturë, Omladinu i Sport  
National Coordinator for Culture, Youth and Sport

Na osnovu člana 12. stav 4. Zakona br. 03/I -149 o civilnoj službi Republike Kosovo, na osnovu Zakona br. 04/I-077, o obligacionim odnosima i Odluka br. 01/86 od 25.01.2019 od Vlade Republike Kosovo:

### Objava javnog konkursa za Sporazum o posebnim uslugama

Naziv institucije:	Kancelarija Premijera
Organizaciona jedinica:	Nacionalni Koordinator za Kulturë, omladinu i sport
Radno mesto:	Regionalni podkoordinator
Broj reference:	NKKOS/SPU-001,
Tarifa usluge:	Po dogovoru
Izveštava :	Nacionalnom Koordinator za Kulturë, omladinu i sport
Vrsta ugovora:	Sporazum o posebnim uslugama – (SPU)
Trajanje ugovora:	Šest (6) meseci
Radno vreme:	Puno
Broj izvršioaca:	1 (jedan)
Mesto:	Priština

#### Dužnosti i odgovornosti angažovanih SPU:

- Pomaže u izradi i realizaciji odgovarajućih projekata i usluga u projektima nacionalnog koordinatora za kulturë, omladinu i sport;
- Obavlja dužnosti predviđene planovima rada usvojenim u skladu sa zakonima, propisima i relevantnim pravilima i procedurama, u određenim rokovima;
- Obezbeđuje informacije o osoblju za izvršenje njihovih dužnosti i odgovornosti u okviru Kancelarije nacionalnog koordinatora za kulturë, omladinu i sport;
- Upravlja i koordinira terenske aktivnosti organizovane u okviru projekata Nacionalnog koordinatora Kancelarije za kulturë, omladinu i sport ;
- Vrši koordinaciju rada sa ostalim delovima institucije i komunicira po potrebi sa spoljnim organima;
- Obavlja bilo koji drugi zadatak u skladu sa važećim zakonima i propisima koji mogu biti povremeno traženi na razuman način;
- Izrađuje pisane izveštaje za nacionalnog koordinatora za kulturë, omladinu i sport na dnevnoj bazi.

#### Kvalifikacija, radno iskustvo i veštine:

- Univerzitetska diploma
- 3 godine iskustva
- Vrlo dobre veštine u pisanju i komunikaciji na albanskom jeziku. Poznavanje engleskog jezika obavezno, znanje drugih jezika je poželjno.
- Duboko i specijalizovano poznavanje u specifičnoj stručnoj oblasti stečenoj putem visokog obrazovanja i odgovarajuće obuke;
- Obavezna vozačka dozvola
- Poznavanje važećih zakona i propisa u odgovarajućim oblastima;
- Veštine u komunikaciji, planiranju rada i timskom liderstvu;
- Istraživačke, analitičke, procenjivačke veštine, i u formulisanju preporuka i stručnim savetima;
- Poznavanje rada na kompjuteru u softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Pointu, Access);

Naziv institucije:	Kancelarija Premijera
Organizaciona jedinica:	Nacionalni Koordinator za Kulturë, omladinu i sport
Radno mesto:	Regionalni podkoordinator iz srpske zajednice
Broj reference:	NKKOS/SPU-002,
Tarifa usluge:	Po dogovoru
Izveštava :	Nacionalnom Koordinator za Kulturë, omladinu i sport
Vrsta ugovora:	Sporazum o posebnim uslugama – (SPU)
Trajanje ugovora:	Šest (6) meseci
Radno vreme:	Puno
Broj izvršioaca:	1 (jedan)
Mesto:	Priština

#### Dužnosti i odgovornosti angažovanih SPU:

- Pomaže u izradi i realizaciji odgovarajućih projekata i usluga u projektima nacionalnog koordinatora za kulturë, omladinu i sport;
- Obavlja dužnosti predviđene planovima rada usvojenim u skladu sa zakonima, propisima i relevantnim pravilima i procedurama, u određenim rokovima;
- Obezbeđuje informacije o osoblju za izvršenje njihovih dužnosti i odgovornosti u okviru Kancelarije nacionalnog koordinatora za kulturë, omladinu i sport;
- Upravlja i koordinira terenske aktivnosti organizovane u okviru projekata Nacionalnog koordinatora Kancelarije za kulturë, omladinu i sport ;
- Vrši koordinaciju rada sa ostalim delovima institucije i komunicira po potrebi sa spoljnim organima;
- Obavlja bilo koji drugi zadatak u skladu sa važećim zakonima i propisima koji mogu biti povremeno traženi na razuman način;
- Izrađuje pisane izveštaje za nacionalnog koordinatora za kulturë, omladinu i sport na dnevnoj bazi.

#### Kvalifikacija, radno iskustvo i veštine:

- Univerzitetska diploma
- 3 godine iskustva
- Vrlo dobre veštine u pisanju i komunikaciji na albanskom jeziku. Poznavanje engleskog jezika obavezno, znanje drugih jezika je poželjno.
- Duboko i specijalizovano poznavanje u specifičnoj stručnoj oblasti stečenoj putem visokog obrazovanja i odgovarajuće obuke;
- Obavezna vozačka dozvola
- Poznavanje važećih zakona i propisa u odgovarajućim oblastima;
- Veštine u komunikaciji, planiranju rada i timskom liderstvu;
- Istraživačke, analitičke, procenjivačke veštine, i u formulisanju preporuka i stručnim savetima;
- Poznavanje rada na kompjuteru u softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Pointu, Access);

Naziv institucije:	Kancelarija Premijera
Organizaciona jedinica:	Nacionalni Koordinator za Kulturë, omladinu i sport
Radno mesto:	Asistent regionalnog podkoordinatora
Broj reference:	NKKOS/SPU- 014, 015,
Tarifa usluge:	Po dogovoru
Izveštava :	Nacionalnom Koordinator za Kulturë, omladinu i sport
Vrsta ugovora:	Sporazum o posebnim uslugama – (SPU)
Trajanje ugovora:	Šest (6) meseci
Radno vreme:	Puno
Broj izvršioaca:	2 (dva)
Mesto:	Priština

#### Dužnosti i odgovornosti angažovanih SPU:

- Pomaže regionalnom podkoordinatoru u izradi i realizaciji projekta i usluga u projektima nacionalnog koordinatora za kulturë, omladinu i sport;
- Obavlja dužnosti predviđene planovima rada usvojenim u skladu sa zakonima, propisima, relevantnim pravilima i procedurama u određenim rokovima;
- Pomaže podkoordinatoru u vršenju istraživanja, analize, procenu mogućnosti i preporuka za razmatranje od strane najviših nivoa o dužnostima ili specijalizovanim projektima odobrenim za nacionalnog koordinatora Kancelarije za kulturë, omladinu i sport;
- Obezbeđuje informacije za izvršenje njihovih dužnosti i odgovornosti u okviru Kancelarije nacionalnog koordinatora za kulturë, omladinu i sport;
- Pomaže u oblasti promocije strateških investicija prema potrebnoj stručnosti u ustanovi;
- Upravlja i koordinira terenske aktivnosti organizovane u okviru projekata Nacionalnog koordinatora Kancelarije za kulturë, omladinu i sport;
- Vrši koordinaciju rada sa ostalim delovima institucije i komunicira po potrebi sa spoljnim organima;
- Obavlja bilo koju drugu dužnost u skladu sa važećim zakonima i propisima koji mogu biti povremeno traženi na razuman način;
- Izrađuje pismene izveštaje za regionalnog podkoordinatora na dnevnoj osnovi.
- Izrađuje pisane izveštaje Nacionalnom koordinatoru za kulturë, omladinu i sport na osnovu njegovih zahtjeva.

#### Kvalifikacija, radno iskustvo i veštine:

- Diploma srednje škole
- Vrlo dobre veštine u pisanju i komunikaciji na albanskom jeziku. Poznavanje engleskog i srpskog jezika je poželjno.
- Da poseduje sananja o celokupnom sistemu obrazovanja na Kosovu
- Veštine u komunikaciji, planiranju rada i timskom liderstvu;
- Istraživačke, analitičke, procenjivačke veštine, i u formulisanju preporuka;
- Poznavanje rada na kompjuteru u softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Pointu, Access);

### OPŠTI PODACI ZA KANDIDATE U VEZI POSTUPKA ZA KONKURISANJE

Kandidati zainteresovani za angažovanje po **ugovoru za posebne usluge**, mora da podnese sledeća dokumenta:

- CV;
- Motivaciono pismo;
- Dokumentaciju predviđena u uslovima zapošljavanja (dokaz o stručnoj spremi, radnom iskustvu, reference i bilo koji drugi dokument koji pokazuje i potvrđuje ispunjenje kriterijuma relevantne oblasti);
- Certifikat (dokaz) da nije pod istragom;
- Kopiju lične karte.

Dokumentacija treba da bude u zapečaćenoj koverti i treba se predati u Kancelariji Narodnog koordinatora za kulturë, omladinu i sport / Kancelarija premijera, na Trgu Majke Tereze, zgrada Vlade, VIII sprat, kancelarija br. 806 ili putem pošte, koje nose poštanski žig stavljen poslednjeg dana isteka roka, će se smatrati validnim i biće uzeti u obzir ako stigne u roku od 4 dana; Aplikacije koje stignu nakon isteka toga roka i nepotpune prijave se odbacuju.


O naknadi se može pregovarati.

Kancelarija nacionalnog koordinatora za kulturë, omladinu i sport / KP, pozdravlja aplikacije svih osoba muškog i ženskog pola, i od svih zajednica.


Za dodatne informacije možete biti obavesteni putem telefona: **038 200 14 060**

Bići kontaktirani samo kandidati izabrani za uži izbor.

**Rok za prijavu je otvoren 7 dana od dana objavljivanja, od dat. 25/01/2020 do dat. 31/01/2020.**



Republika e Kosovës  
Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/50  
Më: 24.01.2020

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018. Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

## KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës  
Viti shkollor 2019/2020

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	orë
1	SHFMU" Gjergj Fishta" në Senik	Mësimdhënës i lëndës së Biologjisë me 4 orë mësimi në javë dhe 2 orë mësimi të lëndës zgjedhore - Ekologji	i lirë	1	6
2	SHFMU" Emin Duraku" në Dragobil	Mësimdhënës i ciklit fillor	zëvendësimi lehonisë me kohë të caktuar deri në kthim të punëtores	1	20

**I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit
- Rezimeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore (nëse ka)
- Certifikata e lindjes

**II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës mësimdhënës të lëndës së biologjisë kërkohet kualifikimet: **Niveli master arsimor- Fakulteti i Edukimit (300 ECTS); Sistemi katërvjeçar; Bachelori (katërvjeçar 240 ECTS)**. Ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018, datë 20.07.2018.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës mësimdhënës të programit fillor kërkohet kualifikimet: **Fakulteti i Edukimit- programi fillor; Fakulteti i Mësuesisë** ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018 datë 20.07.2018

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

**III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.**

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

**SQARIM:** Kandidatët mund të konkurrojnë në më shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

*Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.*


*Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë, orari i intervistave, rezultatet e testit me shkrim, njoftimin për intervistën me gojë dhe vendimin për përzgjedhjen e kandidatit fitues do të publikohen në ueb-faqen e Komunës së Malishevës dhe tabelën e shpalljeve.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa originalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.


**Afati dhe mënyra e aplikimit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **24.01.2020 deri më datën: 07.02.2020.**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo  
Komuna Dragash/Opština Dragaš / Dragas Municipality



Dt.25/01/2020

Në bazë të nenit 8 paragrafi 1. Dhe 2. të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës Nr.03/L-212, kërkesës së drejtorit të QKMF Dragash me nr.02.111/01-1698/20 dt.22/01/2020, aprovimit nga kryetari i Komunës së Dragash-it Shërbimi I Personelit K.Dragash shpallë:

## KONKURS

për Komunitete

- Vendi i Punës; Punëtor teknik-Pastrues në QKMF, QMF dhe AMF-Dragash
- Niveli i pages; H-74 314 eu bruto
- Periudha e kontrates; 12 muaj me mundësi vazhdimi
- Oret e punës; 40 orë në javë
- Përgjegjës-mbikqyrës ;Drejtori i QKMF

**Kushtet për punëtor teknik-pastrues :**

- Të jenë shtetas/c të Republikës së Kosovës;
- Të jenë mbi moshën 20 vjeçar/e dhe max. 40 vjeq;
- Të kenë të kryer shkollën fillore ;
- Të jetë një entuziast dhe i /e aftë për të punuar;
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik ;


**Detyrat dhe përgjegjësit**

Të bëjë pastrimin dhe të mirëmbajë higjienën mbrenda objektit të QKMF-së dhe jashtë objektit;


- Të bëjë menagjimin e mbetjeve medicinale si dhe
- Kryerja e detyrave tjera sipas udhëzimit të mbikqyrësit;
- Aplikacionet merren në zyrën e Personelit nr.9 -K.Dragash;
- Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet;
- Letërnjoftimi, ekstrakti i lindjes, diploma fotokopje e vërtetuara te noteri, vertetimi për përvojën e punës;
- Dokumentet e pa kompletuara nuk merren në shqyrtim;
- Afati i konkurrimit është **15 ditë** nga dita e publikimit në gazetë;

Vërejtje;Kandidatët të cilët konkurrojnë për këtë pozitë duhet të jenë qytetar të integruar në institucionet e Republikës së Kosovës.

**Shërbimi i Personelit  
Dragash**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo  
Komunal Dragash/ Opština Dragaš / Dragas Municipality



Dt.25/01/2020

U skladu sa članom 8 stav 1. i 2. Zakona o Radu Republike Kosova br. 03 / L-212, zahtev direktora GCPM-a O. Dragaš br. 02.111 / 01-1698 / 20 dt.22 / 01/2020, odobreno od strane predsednika Opštine Dragaša, Kadrovska služba objavljuje:

## KONKURS

(za zajednice)

- Radno mesto: Tehnički radnik-Čistač objekta GCPM-a, CPM-a, APM-a O.Dragaš
- Nivo plate: H-74 314 eu bruto
- Period ugovora: 12 meseci sa mogućnošću produženja
- Radni sati: 40 sati nedeljno
- Nadležno lice: Direktor GCPM-a

**Uslovi tehničkog osoblja-čistač:**

Da bude državljanin Republike Kosovo;  
Da je između 20 i max 40 godina starosti  
Da ima završenu osnovnu školu;  
Da bude entuzijasta i sposoban za rad;  
Da ima sposobnost efikasnog rada u multietničkom okruženju;

**Dužnosti i odgovornosti.**

Da čisti i održava higijenu unutar i izvan objekta GCPM-a,;  
Da izvršava druge dužnosti prema nalogu nadzornika;  
Aplikacije se uzimaju u kancelariji Kadrovske službe br.9 -O.Dragas.  
Aplikaciji se prilažu dokumenti: lična karta, ekstrakt rodnih, fotokopija diploma sertifikovana od strane notara, potvrda o radnom iskustvu.  
Nepotpuna dokumentacija se neće razmatrati.  
Rok za konkurs je **15 dana** od dana objavljivanja u novinama.

**Napomena:** Kandidati koji konkurisu za ovu poziciju trebaju biti integrisani građani u institucijama Republike Kosova.

**Kadrovska služba O.Dragas**

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “Supreme Foodservice GMBH Branch Office Kosovo” dega në Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: 70560534 me nr. fiskal: 600530093 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Supreme Foodservice GMBH Branch Office Kosovo”, organak na Kosovo, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom 70560534 me nr fiskal: 600530093 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “Supreme Foodservice GMBH Branch Office Kosovo”, branch in Kosovo, has come to the decision to quit its business 70560534 nr. fiskal: 600530093, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**RESTAURANT**

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/giejpuneshpeite](http://www.facebook.com/giejpuneshpeite)

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► "Lux Dentima" SH.P.K. me numër të biznesit 810190249 me adresë në Prishtinë, Rr, Elbasanit p.n i njofton të gjithë debitorët dhe kreditore se ka marrë vendim për zvogëlimin e kapitalit themelor, Zvogëlimi i kapitalit themelor do të bëhet nga shuma fillestare 50000 (pesëdhjetë mijë ) në 5000 Euro.

► Jusuf Dervari shpall te pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren

► Shukri Shala shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Andi Firzi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Ymer Lumi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Driton Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Fadil Hisari" Prizren

► Lendita Misini shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Reshat Gashi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Nashkim Berisha shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Vezir Agushi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Armend Smani shpall te pavlefshme certifikatën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Bekri Bytyai shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Ibrahim Fehmiu " Prizren

► Blendi Kanashaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Rijad Selmani shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Valbone Buqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Emin Duraku" Prizren

► Gokben Jilta shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Avdyl Frasheri" Prizren

► "Lux Dentima", SH.P.K. me numër të biznesit 810190249 me adresë në Prishtinë, Rr, Elbasanit p.n i njofton të gjithë debitorët dhe kreditore se ka marrë vendim për zvogëlimin e kapitalit themelor, zvogëlimi i kapitalit themelor do të bëhet nga shuma fillestare 50000 (pesëdhjetë mijë ) në 5000 Euro.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistranja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.  
Tel. 044-413-197.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

